



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
KUVENDI I KOMUNES



12 Nr. *060-10797* dt. *22.02.2018*

**Mbledhja e rregullt
Kuvendi Komunal
30.01.2018**

PROCESVERBAL

**I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më
dt.30.01.2018**

Mbledhjen e kryesoi LABINOT HALILAJ – Kryesues

**Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të rregullt të Kuvendit
Komunal ku të pranishëm ishin 30 anëtarë**

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Proces verbali i dt: 27.12.2017
2. Rishqyrtim i vendimit të Komiteti për Politik dhe Financa të dt: 27.12.2017 më kërkesë të MAPL-së
3. Propozim vendim për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të pronës se -ish Kooperativës bujqësore të OP "Drenica" në Drenas (Glllogoc)
4. Propozim vendim për caktimin e komisionit për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis
5. Propozim vendim për hartimin e planit zhvillimor Komunal
6. Propozim vendim për fillimin e procedurave për hartimin e hartave zonale
7. Raporti vjetor i buxhetit për vitin 2017
8. Propozim vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm në pjesën e ngastrës kadastrale nr.201 zona kadastrale në Komoran dhe ngastra kadastrale Korreticë e Epërme nr.29

Prezentuan: Kryetari i Komunes z. Ramiz Lladrovci ,perfaqësues te KFOR-it, perfaqësues të OSCE-së dhe perfaqësues të mediave

Takimi filloi punimet në ora 10:15

LABINOT HALILAJ – Shpalli te hapura punimet e kesaj mbledhje i cili i njoftoj te pranishmit me rendin e dites dhe kerkoj nga të pranishmit se a pajtohen më këtë rend dite,

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-kërkoj që në rend ditë të hyjë edhe nje pike shtese Propozim Vendimi për shpallje më interes të përgjithshem të ngastres kadastrale numer 523-2 me sipërfaqe 8-hektarë 90-ari e 80m zona kadastrale Zabel i ultë,dhe deri me 7-shkurt ne jemi të obliguar që ta dergojmë këtë dokument ne Ministrin e kultures sepse jemi perfitues të një granti në vlerë prej 220.000mije euro për ndertimin e një fushe sintetike,kjo pron është pjesa ku ka qenë antena ku i ploteson të gjitha kushtet për një fushë sintetike un kërkoj q t hyj n rend dite

SABRIJE KUKAJ-unë nuk jamë kunder këtij propozim vendimi ,por 8 h.për një fushë futbollit po më duken shumë mir sht me dit a kemi mundësi q at pjes me shfytzu edhe pr diqka tjeter.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-dha arsyetimin rrethë këtij propozimi dhe deklaroi se kjo parcelë është një zonë e vetme ,nuk është fjala vetëm për një fushë futbollit,ne mundë ta shfytëzojmë edhe për projekte tjera që i duhen Komunës,ne kemi një grant që na është ofruar në vlerë prej 220.000mijë euro dhe është interes i komunës që kjo pronë të kthehet në pronë komunale

XHAVIT DRENORI-pak para mbledhjes të kërkohet edhe një pikë shtesë e rendit të dites më duket e paarsyeshme e pikërisht një propozim që ka të bëjë më pronat, kjo është e jahstëligjshme,ne me koleget tanë e kemi diskutu edhe rendin e dites ku disa prej pikave të rendit të dites as që është dashtë të futen në rend dite, pasi që këto propozim vendime është dashtë të kalojnë paraprakisht nëpërmes komitetit për politik dhe financa ku parashihet edhe më nenin 52.2 të ligjit për vetqeverisje lokale e pastaj të vinë në kuvend, kjo është shkelje e ligjit,por unë kërkoj që nga rendi i dites të hiqen nga pika 3 deri të pika 8 ,të diskutojmë vetëm për piken 1 dh 2 e jo edhe për pikat tjera, të shtohen edhe pika tjera që nuk e dimë as për qka po bëhet fjalë,më marrë vendim pa e ditë për qka është fjala,materialin është dashtë ma heret me pasë për ta ditë se për qka bëhet fjalë, e sidomos në këtë rast kur bëhet fjalë për dhënje të pronës, në rast se ne marrim vendim me hy në rënd dite ky propozim që dha kryetari dhe pika tjera që janë ne rënd dite pa kalu nepermes komitetit pr politik dhe financa ne po bëjmë shkelje të ligjit dhe në këtë rast unë do ti drejtohem MAPL-së për këtë qeshtje.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-ta kam thanë më heret dhe perseri po te them se jeni axhami politik,ne këtu jemi duke kërkuar më marrë pronë jo më dhanë pronë,është interes i pergjithshem publik për sportin dhe sportëdashesit e komunes sonë dhe ka të bëjë me një pronë,fjala është për një zonë kadastrale në sipërfaqe prej 8h e 90 ari e 80metra me nje vend në Zabel te ulet ,unë kamë të drejtë më propozu, dhe në këtë rast unë kerkoj nga ju që të hyj në rënd dite kjo pikë sepse kemi të drejt pasi që kuvendi është organ më i lart i komunes se sa komiteti për politik dhe financa

LABINOT HALILAJ-më ligj na lejohet , mundë të propozojmë edhe një pikë shtesë në rendin e dites ,në këtë rast kryetari ka sjellë propozimin unë kërkoj nga ju që kjo pikë të hyjë në rend dite dhe ta hedhim në votim rendin e dites edhe më një pikë shtesë

XHAVIT DRENORI-unë për këtë rend dite dhe për pikën që po kërkon më hy në rend dite kisha kerku që të pyetet në këtë rast MAPL-ja dhe të mos bëjmë shkelje,por unë kamë një pyetje për kryetarin se qka është fjala axhami politik se nuk po ju kuptoj....

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-fjala axhami është fëmij...

XHAVIT DRENORI-nese unë jamë fëmij ,ju jeni analfabet...

SABRIJE KUKAJ-kerkoj që ti leni këto fjalë dhe të mos perdoret ky fjalor në kuvend,përndryshe nese vazhdoni më këtë fjalor ne femrat po dalim nga salla dhe vazhdoni ju pa ne mbledhjen

SOKOL BYLYKBASHI-një fjalë e urtë popullore thotë dita e mirë shihet në mengjes,edhe këtu qysh ka fillu mbrapsht edhe përfundon,por unë kërkoj një sqarim ,rrethë një kerkese që kemi berë më dt.22.01.2018. për një mbledhje të jashtëzakonshme dhe ende nuk është thirrë ku është dashtë të mbahet para kësaj mbledhje, q nga fillimi i seancave jeni duke br shkelje,sa i perket rendit të dites kërkoj të respektohen procedurat ligjore,nuk duhet anashkalu komitetin për politik dhe financa na obligon ligji që qdo akt paraprakisht të kalon nepermes këtij komiteti,dhe në këtë rast unë kërkoj që nga rendi i dites të hiqen pikat nga pika 3 deri të pika 8 pasi që nuk janë përfill procedurat, dhe nuk kanë kaluar keto pika nëpermes komitetit për politikë dhe financa.

SHQIPE ZOGU- i njoftoj anëtarët e kuvendit se ne duhet të vazhdojmë me rendin e dites, asgjë nuk na pengon ajo pse aktet nuk kanë kalu nepermes komitetit ne duhet të vazhdojmë punen unë e perkrtahu këtë rend dite dhe kërkoj nga kryesuesi që rendi i dites të hidhet në votim edhe me piken shtes q propozoi Kryetari

BEQIR KIQINA-unë përkrahu këtë propozim vendim dhe kërkoj që kjo pikë të jetë pjesë e rendit të dites,por kërkoj nga drejtoresha e kultures të na japë sqarim rrethë këtij propozim vendimi dhe plani se qfarë parashihet,po përmendi dhe një fakt që jemi kuvendi që kemi mbajtur më se shumti mbledhje dhe me se pakti kemi punuar,kamë edhe një kerkese për kryesuesin që te respektohet rregullorja dhe te vazhdoj me rendin e dites

NEXHMEDIN BALAJ-nuk është e domosdoshme që aktet të kalojnë nëpermes komitetit për politik dhe financa ,unë jamë që me u përfill procedurat por propozimet janë më interes të pergjithshem për komunën unë e përkrahu këtë propozim

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-ju e dini shumirë se kuvendi i drenasit prej shtatorit nuk ka mbajtur mbledhje dhe nuk kemi pasë mundësi ma heret me i pru propozimet në kuvend,sa i perket këtij propozimi ne kemi shpreh interesim që per komoran dhe t rinjet e kësaj ane të kemi një fushë sintetike,nuk kemi gjetë as një pronë që i plotëson kushtet për fushë,dhe ne kemi identifikuar këtë parcel në zabel vend ku i plotëson të gjitha kushtet per ndertimin e kësaj fushe sintetike , unë kërkoj që kjo pikë të hyjë në rend dite dhe të votohet

XHAVIT DRENORI-kerkoj që kryetari ta terhjek fjalën axhami,fëmij para të gjithëve është fyerje

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-unë kamë kredibilitet nuk e terhjek fjalën jeni axhami politik..

XHAVIT DRENORI-ti pra je analfabet..

VEHBI BERISHA-më fol pa pasë një dokument para vetës,nuk di as qka flas e as qka po votojmë,nuk kemi të drejtë më marrë vendime hava,ky lloj diskursi në mesë të xhavitit dhe kryetarit nuk po më pelqen fare,të vazhdojmë më rendin e dites e të mos merremi më fjalë të panevojshme

ARTA XHYLANI-qka është kah bahet e kah flitet në këtë kuvend ,fjalet i keq,analfabet,axhami e shumë fjalë tjera që po perdoren janë të paarsyeshme kërkoj të respektohet rendi i dites dhe t mos etiketojmë njeri tjetri

SHQIPE ZOGU –po lidhem më rastin e nismes ,Nexhmedin Balajt i cili i përkrahu vendimet në emer të nismes ndersa kur ndegjova z.Vehbi Berisha gjat diskutimit nuk mund e kuptova se a janë dakordu si grup parlamentar apo po japin mendime individuale.

BEDRI NIKA-ky propozim nuk ka të bëjë me dhënjën e prones ,por marrjen e prones nga AKP-ja dhe është në interes të qytetarëve të Drenasit,unë kërkoj të distancohem nga fjalori i përdorur nga xhavit drenori,një njeri kur humbë nuk e di as ku është,ky nuk perfaqëson askend,ky din vetëm me mashtru,pas lufte ka bajtë edhe mobilje prej prishtine tuj marrë neper banesa,ky e ka ndryshu edhe mbiemrin pr nj t mir nuk e ka ndryshu që e ka pas avdyli, dhe ne kemi shumë respekt per atë lagje dhe atë mbiemër,por unë kërkoj që ky fjalor në kuvend të mos perdoret dhe të distancohem nga ky fjalor

XHAVIT DRENORI-kolegu në fjalë është zënë me para falls nga policia,dhe është duke punuar për të marrë byfenë e kuvendit të kosoves e i vënë vota për të realizu qëllimet e veta ky është në Pdk

BEDRI NIKA-unë po të informoj se unë punoj për familjen time,por tipat si ti që i ndrronë mbiemrat tek unë nuk qojnë peshë,nese dikush sht n pdk jeni ju se i keni ndrru partitë unë kërkoj kryesues të vazhdojmë me mbledhje

PETRIT GASHI-kur është bërë ky ndryshim në kuvend unë kamë pasë mendimin se do të ketë ndryshime për të mirë dhe në interes të qytetarëve,propozimi që ka ardh është në interes të sportit dhe sportdashësve edhe gjat fushates shumë sht premtu se do t perkrahet sporti dhe sportdashsit,propozimi ka për qëllim që prona ti kthehet komunës,ne e përkrahim këtë propozim dhe kisha kerku që rendi i dites të hidhet në votim dhe t mos merremi m thash e theme ne jemi kuvend duhet t vazhdojmë punen

BEQIR KIQINA-ne aak-ja jemi per të gjitha propozimet që janë në interes të qytetarëve unë vetëm kërkoja sqarim nga drejtoresha e kultures rreth planit për këtë fushë sintetike,kërkoj nga kryesuesi q t shkojmë m votim pr rendin e dites

LABINOT HALILAJ-hodhi ne votim rendin e dites edhe më një pikë shtese t propozuar nga Kryetari i Komuns

Me rastin e votimit prezent ishin 30 anëtarë

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:25

Kundër:0

Abstenim:05

LABINOT HALILAJ-hapi diskutimin për piken e parë të rendit të dites

1. Proces verbali i dt: 27.12.2017

Pasi që nuk pati diskutime dhe vërejtje për kete pikë të rendit të dites

LABINOT HALILAJ-hodhi në votim këtë pikë të rendit të dites

Me rastin e votimit prezent ishin 30 anëtarë

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:30

Kundër:0

Abstenim:0

LABINOT HALILAJ-hapi diskutimin për piken e dytë të rendit të dites

2.Rishqyrtimi i vendimit të Komiteti për Politik dhe Financa të dt: 27.12.2017 më kërkesë të MAPL-së

SHQIPE ZOGU-deklaroj se grupi parlamentar i pdk-së ka respektuar ligjin dhe udhëzimin administrativ ka reflektu si në numer poashtu edhe në kuoten gjinore kemi propozuar dy anëtarë njeri prej ketyre anëtarëve i perket gjinis femrore

NEXHMEDIN BALAJ-duke u mbështetur në udhëzimin administrativ në nenin 6 pika 1 dhe 2 e këtij udhëzimi që përcakton përberjen e këtij komiteti e që duhet të përfshihen të gjitha entitetet sipas renditjes së subjekteve në kemi arrit një marrëveshje dhe në këtë rast jemi pajtuar dhe i propozojmë këta kandidat për KPF-ca si: Burim Bujupi nga Nisma, Xhavit Drenori nga Vizioni, Sokol Bylykbashi nga VV dhe Edolina Plakiqi nga AAK-ja

LABINOT HALILAJ-të nderuar anëtarë të Kuvendit ,propozimet që u dhanë perseri nuk po respektohet kuota gjinore ta respektojmë ligjin dhe udhëzimin administrativ

SHQIPE ZOGU-grupi parlamentar i PDK-së qendron me propozimet që i kemi dhanë edhe në mbledhjen e kaluar kandidatet janë: Gani Podrimqaku dhe Blerina Gashi

PETRIT GASHI-kamë një sqarim, po shihet se paskan bere marrëveshje politike, por në këtë rast nuk mundë të përjashtohen edhe partit tjera, jemi të barabartë me ligj, as në mbledhjen e kaluar nuk ka pasë shkelje të ligjit, sa i perket perfaqësimit nga partitë por për shkak se nuk është respektu kuota gjinore, ne për këtë qështje kemi bisedu edhe në MAPL-dhe kanë sqaru se nese psh janë 8 anëtarë një grup dhe partitë tjera sipas renditjes perfaqësimi është 50% me 50%, por unë kisha kerku në këtë rast nese zgjidhet dikush nga AAKja sot të bëhet më rotacion që pas dy viteve të zgjidhet dikush nga keta kater anëtarët e tjerë që janë të perfaqësuar në kuvend kjo është zgjidhja më e mirë

BEQIR KIQINA-në këto raste nuk njihen grupacionet politike, njihen subjektet politike sipas votave dhe renditjes që kanë fituar për kuvend, ju në këtë rast po shkelni ligjin

PETRIT GASHI-unë jamë duke përfill ligjin por nese në këtë rast kastrati ka kalu në pdk -këtij subjekti i takojnë 4 anëtarë në komitetin për politik dhe financa ,unë kisha kerku që të ketë një marrëveshje të përfshihen entitetet dhe të respektohet kuota gjinore t veprohet sipas ligjit dhe udhëzimit administrativ

NEXHMEDIN BALAJ-kryesues unë kërkoj të vazhdojmë më rendin e dites, ne kater subjektet sipas renditjes kemi ba një marrëveshje unë i propozova emrat dhe të vazhdojmë më procedurat tjera

BEDRI NIKA-MAPL-ja më këtë vendim ka kerku që të respektohet kuota gjinore në perfaqësimin e komitetit për politik dhe financa pasi që në propozime ka vetëm anëtarë të gjinisë mashkullore unë kisha propozu që Malësore Cakiqi të jetë anëtare e këtij komiteti në mënyrë që të respektohet ligji për barazi gjinore

SABRIJE KUKAJ-apetitët për të qenë pjesë e këtij komiteti na kanë lënë pa e zgjedhur këtë komitet ,ju kisha lut të respektohet ligji e ti lam apetitet shumir e specifikon udhëzimi administrati perberjen e KPF-ca

LABINOT HALILAJ-unë jamë dhe kërkoj që të respektohet ligji dhe udhëzimi administrativ ,unë qysh edhe ma heret kur kemi mbajtë një takim me grupet parlamentare, Nisma ka pasë dy propozime dhe që të dy kanë qenë meshkuj, as atëher e as sot nuk po respektohet kuota gjinore, pastaj e keni thirrë mbledhjen e jashtëzakonshme e kemi mbajtë ashtu siq keni kërkuar ju, unë nuk kamë shkelë ligjin ,po shkelni ju ligjin i dhatë 4 propozime perseri nuk po perfillet kuota gjinore por në këtë rast keni 5 minuta pushim në mënyrë që opozita të merren vesh për kuoten gjinore.

LABINOT HALILAJ-kerkoj nga anëtarët e kuvendit që të vazhdojmë më seancen dhe të shkojmë më propozime konkrete për anëtarë të KPF-ca, duke filluar nga grupi parlamentar i Pdk-së

SHQIPE ZOGU-Grupi Parlamentar i PDK-së propozonë për Komitet per Politik dhe Financa: Gani Podrimqaku dhe Blerina Gashi

NEXHMEDIN BALAJ- Grupi Nisma propozon:Burim Bujupi

ENDRIT GLLAREVA – nga Vizioni per Drenasin propozon :Xhavit Drenori

SOKOL BYLYKBASHI – nga VV-ja propozon: Florentina Elezi

BEQIR KIQINA-nga AAK propozon:Edolina Plaqiqi

LABINOT HALILAJ- hodhi në votim listen e anëtarve të propozuar për Komitet për Politim dhe Financa si :

1.Gani Podrimqaku

2.Blerina Gashi

3.Burim Bujupi

4.Xhavit Drenori

5.Florentina Elezi si dhe

6.Edolina Plaqiqi

Me rastin e votimit prezent ishin 30 anëtarë

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:26

Kundër:01

Abstenim:03

LABINOT HALILAJ-hapi diskutimin për piken e tretë të rendit të dites

3.Propozim vendim për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të pronës së -ish Kooperativës bujqësore të OP "Drenica" në Drenas (Glllogoc)

LUMNIE KRAPI-dha arsytimin rrethë këtij propozim vendimi dhe deklaroi se kjo pronë menagjohet nga akp-ja , si komunë kemi për qëllim që kjo pronë të kthehet në menagjim të Komunës ,fjala është për parcelat ku ka qen edhe m heret tregu i kafshëve dhe është në gjendje të rëndë, në këtë rast kisha kerku që ky propozim të votohet sepse është në interes të komunës

VEHBI BERISHA-ne e kemi tregun e kafshëve në komoran dhe nuk po me duket e arsyeshme që një propozim i tillë të na vijë në kuvend,këtij propozimi është dashtë ti paraprijë një diskutim publik me qytetarë të asaj zone dhe të merret pëlqimi i tyre,është dashtë të studiohet mirë ajo zonë se a i plotëson kushtet për treg apo jo se aty janë edhe banesat sociale

SHQIPE ZOGU-grupi parlamentar i pdk-së e përkrah këtë propozim vendim duke marrë parasysh se është në interes të komunës që kjo pronë që menagjohet nga akp-ja të kthehet nën menagjim të Komunës dhe kërkoj nga kryesuesi që të hidhet në votim

SOKOL BYLYKBASHI-sa i përket kthimit të pronë që është nënmenagjim të akp-së në pronë komunale unë e pergëzoj,kam një pyetje se a janë të ndara këto dy parcela apo jo, kur ka vendime të tilla mirë është që të ketë konsullta paraprakisht dhe të diskutohen edhe me banorë që i takojn asaj zone,se për tregje ne veq e dimë gjendja e tyre është e mjerueshme, e sidomos tregu në komoran nuk i plotëson as kushtet minimale për treg,drejtoria e shërbimeve publike është përgjegjëse për këtë,kur shoh se në qfarë gjendje janë tregjet tona duhet të mirren masa dhe të kenë kritere se si një treg duhet të plotësoj të gjitha kushtet për të funksionuar.

ENDRIT GLLAREVA-në emer të vizionit për drenasin ne mbështesim këtë propozim vendim.

PETRIT GASHI-sa i përket këtij propozimi unë e përkrahu por unë kamë disa kërkesa sepse për të funksionuar tregu duhet të plotësoj disa kritere si:kushtet e sanitarisë,pastaj largësia nga vendbanimet se paku duhet të jet 2500m,pastaj ambienti për mbetjet ,tregu duhet të ketë edhe vendin për therje si dhe zyret e veterinarëve për të funksionuar si duhet.

SABRIJE KUKAJ-gjithëher kamë kerku sa e sa herë që tu bëhet zgjidhje tregjeve sepse janë në gjendje të mjerueshme si tregu i gjelbert në drenas e poashtu edhe tregu i kafshëve në komoran,kushdo që e merr në shfytëzim tregun mirë është që ti përmbahen kontrates por të ketë mbikëqyrje nga drejtorati për shërbime publike .

BEQIR KIQINA-ne AAK-ja jemi pro këtij propozimvendimi,por duhet pasur një menagjim të mirëfillt tregjet, në këtë rast lus kryetarin e komunës që tregu në komoran t ketë nj mbikëqyrje dhe nj menagjim t mirfillt nga inspeksioni se është në gjendje shumë të rëndë,kundërmon erë shumë e ranë, rrezikohen si banort per rreth poashtu edhe personat tjerë që lëvizin aty pari mirë është të ketë një kontroll më të mirë në këtë treg.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-unë ju falënderoj për përkrahje të këtij propozimi,edhe unë jamë që të ketë një menagjim më të mirë ,unë do të perpjekem që kjo qështje të rregullohet e di se gjendja e tregjeve është e rëndë,por ne sot jemi duke diskutuar jo për dhënjën në shfytëzim të pronave por për kthimin e pronave që janë nen menagjim të akp-së nen menagjim të komunës mos me u shitë këto prona se është në interes të të gjithë qytetarëve të Drenasit,një sqarim për tregun në komoran kompania ka kontratë 10 vjeqare me pagesë ka vetëm 2 vjet ndersa për pjesen tjeter nuk ka pasë obligime pasi që ka investuar në atë treg,unë e kamë shqyrtuar këtë kontratë dhe jamë duke shqyrtuar edhe shumëkontrata tjera që janë lidhë më heret nga komuna me kompani t ndryshme.

VEHBI BERISHA-unë edhe më heret kërkova dhe perseri po kërkoj që nese ajo pronë ka per qëllim të ipet për treg të kafshëve kërkoj që paraprakisht të shkohet në diskutim publik dhe të pyeten edhe banoret e asaj zone.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-ne na obligon edhe ligji që për këtë qështje të kemi diskutim publik por ju njoftova se kjo është në inters të komunës dhe qytetarëve që kjo pronë që menagjohet nga akp-ja ti kthehet komunës nuk sht fjala sot pr dhnjen n shfytzim t kësaj prone

SHQIPE ZOGU-propozoi që pasuesi ku permendet në nenin 1 kjo pronë do të shfytëzohet për tregun e kafshëve të hiqet dhe kërkoj nga kryesuesi që më këtë ndryshim të hidhet në votim

XHAVIT DRENORI-mirë është që paraprakisht të hidhet në votim propozimi i vehbiut që kërkoj që ky propozim të dikutohet paraprakisht më publikun pastaj vazhdojmë më propozimet tjera.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-propozimi i Shqipe Zogut ishte më vend dhe e pranoj, kërkoj që ky propozim të hidhet në votim me ndryshime, të hiqet pasuesi ku permendet tregu i kafshëve

LABINOT HALILAJ-hodhi në votim këtë pikë të rendit të dites me ndryshime

Me rastin e votimit prezent ishin 29 anëtarë

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:29

Kundër:0

Abstenim:0

LABINOT HALILAJ-hapi diskutimin për piken e katërt të rendit të dites

4.Propozim vendim për caktimin e komisionit për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis

VEHBI BERISHA-e pashë se isha pjesë e këtij komisioni,unë kamë qenë edhe më heret pjesë e këtij komisioni,kemi tentu sa e sa herë hartimin e këtij plani por kemi deshtuar,ky dokument ka një rëndësi të veqantë dhe donë përkrahje,kemi qenë nder komunat e para që kemi pasë fillu më punu për hartim të këtij plani por nuk kemi

arrit,unë jamë që ky dokument të hartohet sa më parë por donë kohë se edhe ashtu jemi të vonuar,unë kamë një propozim që Plani lokal i veprimt të ndryshoj në vite jo 2018-2023 por të përfshijë periudhën 2019-2024 ,kur dihet se në këtë plan duhet të përfshihen edhe të gjitha projektet e vitit 2018 e buxheti ne e dimë se nuk aprovohet deri në muajin shtator

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-unë jamë kunder propozimit të Vehbisë që plani të ndryshoj në vite,ne jemi në fillim të vitit 2018 dhe është i paraparë për vitet 2018-2023 dhe kështu le të mbetet.

FITORE MORINA-unë shohë se në këtë komision ka të propozuar edhe drejtor të drejtorateve mendoj se disa prej drejtorëve nuk duhet të jenë pjesë e komisionit mirë ka qenë që në këtë komision të ketë edhe propozime tjera nga kuvendi dhe unë për këtë komision propozoj që Endrit Gllareva- të jete pjesë e këtij komisioni.

RAMIZ LLADROVCI-KRYETARI I KOMUNËS-sa i perket drejtorëve që janë të propozuar në këtë komision ne jemi të obliguar më ligjë që drejtoret e fushave të caktuara duhet të jenë pjesë e këtij komisioni,me i hjek nuk mundemi por mundë të rrisim numrin e këtij komisioni,mundeni me propozu antar tjer, vetëm le të jetë numri tek i komisionit, pati një propozim por tash është numri.14, e duhet të jenë 15 apo 17 e jo numer qift.

SHQIPE ZOGU-propozoi Haka Tahiraj që të jetë pjesë e këtij komisioni

PETRIT GASHI-unë mendoj se nese duhet cilësi nuk është më rëndësi numri,mirë është që të kemi një komision që është profesional dhe punon dhe kisha kerku që të mos rritet ma numri dhe të hidhet në votim ky propozim vendim më këtë listë si është.

LABINOT HALILAJ-hodhi në votim këtë pikë të rendit të dites me plotësim edhe t dy antarve q u propozuan nga kuvendi:

Me rastin e votimit prezent ishin 29 anëtarë:

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:29

Kundër:0

Abstenim:0

LABINOT HALILAJ-hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të dites

5.Propozim vendim për hartimin e planit zhvillimor Komunal

XHAVIT DRENORI-plani zhvillimor komunal është dokumenti më i rëndësishem i komunës i cili dokument ka afat deri në vitin 2020,sa i perket kësaj qështje ne kemi qalu në këtë fushë por ne duhet ti kushtojmë shumë rëndësi këtij plani

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-ne jemi të obliguar më ligj që të hartojmë planin zhvillimor komunal, ne paraprakisht duhet ta kemi një vendim të kuvendit e pastaj më u zhvillu procedurat tjera për hartimin e planit

SABRIJE KUKAJ-unë jamë për këtë propozim vendim, por unë kërkoj sqarime shtesë nga drejtorati për urbanizëm ,mirë ka qenë që dikush prej stafit të urbanizmit me kanë prezent dhe me na njoftu ma detajisht rreth këtij propozim vendimi

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-ne duhet me ba ndryshime në plan,jemi të obliguar edhe me ligj po nese ju kërkon që dikush prej urbanizmit me kanë prezent këtu ne po e thërrasim Shabanin apo dikand tjetër e deri sa të vjen dikush prej urbanizmit mundemi më vazhdu më pikat tjera të rendit të dites.

LABINOT HALILAJ-kërkoj që pika 5 dhe 6 të diskutohen pas Raportit vjetor të Buxhetit,pas kërkeses së anëtarëve të kuvendit që dikush prej urbanizmit të na sqarojë per planet

LABINOT HALILAJ-hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të dites

7. Raporti vjetor i buxhetit për vitin 2017

HAMDI KRASNIQI-dha një arsytim rreth raportit vjetor të buxhetit për vitin 2017, sht nj nder raportet m t suksesshme prej q un punoj n kt drejtorat,i njoftoj anëtarët e kuvendit per secilin program t secilit drejtorat veq e veq duke filluar nga planifikimi i bugjetit dhe realizimi i tij ka n përqindje t lart t realizimit t projekteve dhe lirisht mund t them se jemi nder komunat e para q bugjeti sht shpenzu n kt përqindje,raportin e keni para vets dhe pr qdo vrejthe apo sugjerim q keni i mirpres **SHQIPE ZOGU**-perkrah këtë raport ,kemi një përmbledhje dhe një performancë më të mirë sa i perket realizimit të bugjetit ,borgjet veq janë eliminuar dhe projektet kapitale kanë përfunduar në afat.

NEXHMEDIN BALAJ-sa i perket performances unë e përckrah por më shqetëson fakti se si nga grantet kanë mbetë pa u shpenzuar 373mije euro, si dhe nga të hyrat vetanake 87 mijë euro,pse nuk janë shpenzuar këto mjete këto shkojnë suficit,në këtë rast përmendi disa prej drejtorive si drejtoria e shendetsisë,drejtoria e kultures pastaj kemi të drejtoria e arsimit 20.000mijë euro që kanë mbetë pa u shpenzuar pse keto mjete mos me u shpenzu por me shku suficit

XHAVIT DRENORI-më gëzon fakti që ka një performancë më të mirë sa i perket realizimit të bugjetit për vitin 2017 , raporti është i pergjithësuar ne nuk po kemi mundësi që të debatojmë kur nuk janë paraqitur të dhënat në mënyrë të detajuar,por mu më intereson në tab.nr,2ku janë të paraqitura të dhënat për grantet ku vlera e bugjetit është 9623 euro,janë shpenzuar vetem 6045 euro, vetem keto mjete janë grante nga donatorët a që në fakt gjat fushates janë premtuar miliona, pastaj në faqen nr.3,tab.nr.4të zyra e kryetarit po ndalem tek kategoria mallra dhe shërbime ,nuk ka të detajuar se kah janë shpenzu këto mjete,më interson se sa mjete ka shpenzuar për udhëtime jashtë vendit Kryetari pasi q ka pas shum vizita jashtë vendi a nuk ka sjell as nj projekt,tek drejtoria e urbanizmit tab.nr.4.9 janë tepru mjete mbi 200.000mijë euro nga projektet kapitale,si dhe të drejtorati për kulturë,rini dhe sport e pikërisht më interson tek një raport i KVRL-së ku kta t rinj kanë shpenzuar mjete me u shetit nëpër shqipëri, e kanë thënë se kanë qenë një vizit studimore që në fakt nuk qëndron ashtu,dhe shpenzimin e mjeteve nuk e kanë bërë si duhet dhe siq shihet edhe këtu nga këta të rinj ka keqëperdorim të bugjetit të komunës dhe për këtë rast mundë të ndodhë që do të kërkoj auditim

HAMDI KRASNIQI-u përgjigj në disa pyetje të parashtruara nga disa anëtarë të kuvendit si:të grantet e donatorëve e keni keqë kuptuar, sa i perket secilit shpenzim që është bërë ne kemi raportin analitik dhe këtu ne jemi duke diskutuar rrethë raportit financiar që janë të dhënat e pergjithëshme për secilin program sa mjete kanë pasur bugjet për vitin 2017 dhe sa kanë shpenzuar,nese dikujt i intereson per secilin shpenzim në mënyrë të detajuar jeni të lirë dhe pas mbledhjes apo kurdo që ju keni kohë të lirë ne jemi të gatshem tju ofrojmë të gjitha të dhënat që ju interson,sa i perket shpenzimeve të kryetarit për udhëtim jashtë vendit gjatë vitit 2017 ka shpenzuar 500euro,në këtë vitë kemi pasur disa probleme sa i perket kodit pesëshifror dhe nuk kemi mundë me realizu bugjetin në tansi, për herë të parë dhe i vetmi që ka ndodhë alokimi i mjeteve në këtë vitë,kjo nuk ka ndodhë me fajin tonë ky problem është përcjell edhe nivel vendi.

FLUTURA AVDIU-më vjen keq që i qasesh rinisë në këtë formë iu drejtua në këtë rast xhavit drenorit ,sa i perket projektit që ka pasë rinia gjithëqka është në rregull dhe janë të gjitha faturat që dëshmojnë për secilin shpenzim dhe nuk ka keqëperdorim dhe është një nder raportet më të mira që detajon se cilin shpenzim ku është bërë.

IDRIZ HYSENAJ -jemi krenar për punen që kemi bërë gjatë vitit 2017,e kemi realizu planin në mënyren më të mirë,300mijë euro të mbetura janë mjete nga të hyrat vetanake dhe nuk humbin,keto mbetje janë nga disa projekte që kanë deshtuar punëkryesit në punen e tyre nuk janë me fajin tonë ,ne nuk mundë të paguajmë mjete pa u kry punimet dhe punëkryesit kanë deshtu në realizimin e kontrates që kanë pasë më komunën

TAFIL HALILAJ-mjetet që kanë mbetë pa u shpenzuar kanë qenë mjete të mbetura nga projektet e rrethojave,dhe nuk kemi pasë ma kohë të mjaftueshme për ti rishpallë,ndersa sa u perket bursave për student janë realizu ashtu siq është parashiku por kemi pasë kërkesë nga ministria që për secilin student të dihet sakt se prej cilit kod po paguhen dhe i kemi ofru të gjitha të dhënat ashtu siq kanë kërkuar.

XHAVIT DRENORI-unë i falënderoj drejtoret për arsyetimet që dhanë por po ndalemi pak tek projektet kapitale që janë realizu, pse është ndryshu projekti i rruges që ka qenë qikatov-dobroshevc që më vendim të kuvendit ka qenë ,ndersa kjo rrugë është shtru vetëm deri të lagja e bunjakëve në Gllanasellë,e sa i perket drejtoreshes se kultures që mu drejtua se une po i fyej të rinjet,unë i thamë drejtoreshes se mos edhe ju keni vjedh në këtë rast që po i mbronë të rinjet ,unë qdo ditë rri më të rinjet por thash se ata të rinjë nuk kanë shkuar në vizitë studimore por kanë shku me u shetitë në shqiperi.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-sa i perket projektit të rruges qikatov –dobroshevc ne e kemi shtru deri të lagja bunjaku ne e kemi ndryshu,ndersa sa i perket drejtoreshes se kultures që po e akuzoni,ne krenohemi me punen që bënë,është një drejtoresh që ka të përfunduar krejt fakultetin dhe masterin me 10 tshe e ka edhe provimin e jurispodences të përfunduar,mos luani me ndjenja të qytetarëve,vota është peshë me hup në katund tanin ma as vota nuk kisha kerku,a po e sheh veten se në qfarë niveli keni ra,shumë i paedukum po tregohesh,mos u shitë mend kerkujt,po e perseiti se je nje axhami politik.

XHAVIT DRENORI-kur një kryetar më quan femi,unë jamë i lumtur kush më thotë një njeri si ju analfabet,unë nuk lejoj që drejtoret të më fyejnë nuk kanë të drejtë

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-mu më kanë zgjedhë më teper se 60%e qytetarëve të drenasit për kryetar, ti je dukei fyer të gjithë ata votues që mkanë votu simbas teje të gjithë ata qenkan analfabet je tuj fy të gjithë qytetaret e drenasit në këtë rast jo mu.

EDOLINA PLAKIQI-raporti nuk është e thane veq me perfshi numra,është raport që nuk janë paraqit të dhënat në mënyrë të detajuar por në mënyrë të pergjithësuar,ne është dashtë të njoftohemi sakt se ku kanë shkuar mjetet ,ku janë shpenzuar ato mjete e jo në këtë mënyrë si na ka ardhë ky raport.

SOKOL BYLYKBASHI-sa i perket pasqyrave financiare këtij raporti i mungon gjithëqka,ky raport është shumë i mangët sepse i mungon sqarimi ,pra për secilin sektor mungojnë të dhënat as një element nuk e ka që sqaron se ku janë shpenzu mjetet,si psh.tek shpenzimet për mallra dhe sherbime per as një sektor nuk janë të paraqitura të dhënat se si janë shpenzu,si mundë të diskutojmë për një raport kur i mungojnë të dhënat,pse mos me u paraqitë të dhënat më të detajuara si janë shpenzu mjetet,sa janë shpenzu për udhëtime zyrtare,sa për telefon apo dreka zyrtare e shumë shpenzime tjera por ketu nuk mundë ti paraqiteni te dhënat sepse sa herë ka zgjedhje Pdk-ja i shfrytëzon resurset dhe bugjetin e komunës për parti ,ne kerkojmë që të dhënat në raportin financiar të vijnë në mënyrë të detajuar ta dimë sakt secilin shpenzim ku dhe si është shpenzu e jo në këtë mënyrë.

SABRIJE KUKAJ-perqindja e këtij raporti sipas të dhënave tek të hyrat vetanake po del të jetë e mirë, por kamë pyetje për disa drejtori se pse nuk janë realizu disa prej

projekteve si te drejtoria e sherbimeve publike,pastaj drejtoria e adminstrates drejtoria e shendetsisë disa projekte tjera që kanë mbetë pa u realizuar.

VEHBI BERISHA-sipas një hulumtimi që ka bërë instituti gap po del se ne jemi nder komunat më transparente dhe kjo është një sukses,pamvarësisht kush vleron ne duhet tu besojmë ketyre vlersimeve e sidomos një instituti që merret më këtë hulumtim

PETRIT GASHI-edhe unë jamë që raporti financiar të vijë më i kompletuar e jo në këtë mënyrë,duhet të dhënat të jenë më të detajura dhe të dimë sakt per secilin shpenzim që është bërë

QENDRIM MULAJ-unë e pergezoi këtë raport dhe unë kisha kerku ky raport të hidhet në votim nuk kemi se qka të vazhdojmë më tutje

PETRIT GASHI-mos e merrni diskutimin tim si kritik por si këshill,sepse raporti ka edhe anët pozitive por edhe ato negative

LUMNIE KRAPI-ke pyetja për njëprojekt se a ka kontratë,po ka kontratë dhe ligji na lejon që të vazhdojmë në realizimin e këtij projekti,

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-të nderuar anëtarë ky është një raport financiar në raport financiar nuk ipen të dhënat në mënyrë të detajuar,është raporti analitik që paraqet të dhënat në mënyrë të detajuar për secilin shpenzim kujdo që i interson për raportin analitik mundeni me ardhë më pa ,raporti financiar nuk votohet ,ne vetëm mundë të diskutojmë,qdo sygjerim të juajin që është i arsyeshem e marrim per bazë dhe kisha kerku që të vazhdojmë më pikat tjera të rendit të dites

LABINOT HALILAJ-hapi diskutimin per piken 5 dhe 6 të rendit të dites

5.Propozim vendim për hartimin e planit zhvillimor Komunal

6 Propozim vendim për fillimin e procedurave për hartimin e hartave zonale

IDRIZ HYSENAJ-dha arsyetimin rrethë propozim vendimit për planin zhvillimor komunal dhe propozim vendimit të hartave zonale,ligji per planifikim hapësinor na obligon që ne të hartojmë planin zhvillimor komunal si dhe të hartojmë dhe hartat zonale në mënyrë që të perfshihen në planin zhvillimor komunal si dhe kemi edhe shumë kërkesa të qytetarve të cilet kërkojnë ndryshimin e planit zhvillimor komunal, ndersa sa i perket hartave zonale që do të bëhen për gjith territorin e komunes së Drenasit do të kemi perkrahje nga Gizi gjerman, kompani e cila na ka perkrah edhe në shumë projekte tjera.

SABRIJE KUKAJ-parashtroj pyetje se si do te veprohet në zonat sikurse jemi ne aty ku jetojmë nuk kemi as rrug dhe kemi probleme për shkak të pronave si dhe rastet tjera që ka të shumta në komunën tonë fjala është për tokat që gjinden ne komosacion ku ka shumë ndertime e që duhet bërë zgjidhje

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-ne kemi një plan zhvillimor komunal e që ky plan ka afat deri 2020, ne do ta respektojmë ligjin e planifikimit hapsinor, por sa i perket ndertimeve që janë bërë në komosacion ne nuk kemi të drejt të japim leje sepse ato janë toka bujqesore dhe nuk na lejon ligji, nuk lejohet parcializimi nen një hektarë, pra këtë ligj mund ta ndryshojë vetem Kuvendi Kosoves

BEQIR KIQINA-a do të ndahen hartat zonale për secilin fshatë si p.sh Baic, Terdevc, Abri, apo do të perfshihen vetëm disa zona

IDRIZ HYSENAJ-une edhe me heret ju njoftova se nuk do të ketë ndarje të hartave por do të perfshihet i gjith territori i Drenasit pra Drenasi me gjitha fshatrat që i takojnë

LABINOT HALILAJ-hodhi në votim piken 5 dhe 6 të rendit të dites

Me rastin e votimit prezent ishin 25 anëtarë

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:25

Kundër:0

Abstenim:0

LABINOT HALILAJ-hapi diskutimin për piken e 8 dhe 9 të rendit të dites

8.Propozim vendim për shpalljen e interes të përgjithshem ne pjesën e ngastrës kadastrale nr.201 zona kadastrale në Komoran dhe ngastra kadastrale Korreticë e Epërme nr.29

9.Propozim vendim per shpalljen më interes të përgjithshem të ngastres kadastrale nr.523/2 zona kadastrave Zabel i ulët

MILAIM HAJDARI-dha arsyetimin rreth pikes 8 dhe 9 propozime të cilat kan të bejnë kthimin e pronës nga AKP-ja në pronë komunale, sa i perket propozim vendimit në komoran aty kan qenë dy familje që kan pas në shfrytzim vetëm metrat katror të bannimit njera ka qenë 45m ndersa tjetra 50m ku kemi arrit një marrveshje me keta banues dhe i kan liru keto banesa, ndersa propozimi tjetër ka të bejë më një pronë në zabel të ulet e cila është në një ngaster kadastrale dhe perfshinë një siperfaqe prej 8 hektareve që është edhe kjo pronë e AKP-se dhe qellimi është që kjo pronë ti kthehet komunes dhe në këtë rast unë kisha kerku që keto propozime të hidhen në votim të dyja

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-qellimi i ketyre propozim vendimeve është kthimi i pronës nga AKP-ja në pronë komunale, ne jemi duke punuar më Drejtorinë e Gjeodezisë që kudo ku ka pronë AKP-ja të bejmë kerkesë dhe t'ia kthejmë pronen komunes ky është interes i të gjithë qytetarëve të Drenasit.

SABRIJE KUKAJ-une jamë për atë që qdo pronë që menagjonë AKP-ja ti kthehet komunes, por une e di se ka shumë raste që AKP-ja i ka në posedim edhe pronat private të njerzve që kan jetuar dhe jetojnë që 50-vite aty, në keto raste si do te veprohet sepse ka me pas probleme të medha

NEXHMEDIN BALAJ-une i perkrahi dhe i pergezoi keto vendime sepse kthimi i ketyre pronave në pronsi të komunes është interes i të gjithë qytetareve të Drenasit

LABINOT HALILAJ-hodhi në votim pikat 8 dhe 9 të rendit të dites

Me rastin e votimit prezent ishin 29 anëtarë

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:29

Kundër:0

Abstenim:0

LABINOT HALILAJ- mbylli këtë seancë rreth ores:16 e 30 minuta

Proces mbajtësi

Xhavit Nebihi



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
KUVENDI I KOMUNES



12 Nr. 060 - / 6478 dt. 22.03. 2018

**Mbledhja e rregullt
Kuvendi Komunal
01.03.2018**

PROCESVERBAL

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më
dt.01.03.2018

Mbledhjen e kryesoi **LABINOT HALILAJ** – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të rregullt të Kuvendit Komunal ku të pranishëm ishin 31 anëtarë

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Proces verbali i dt: 30.01.2018
2. Plani vjetor i Punës për vitin 2018 i Kuvendit të Komunës
3. Plani i veprimit për Transparenc për vitin 2018
4. Propozim vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm të rruges “Gani Elshani dhe “Islam Kastrati” që janë pronë e hekurudhave të Kosovës për shpronësim
5. Propozim drafti i Rregullores për tarifa ngarkesa dhe gjoba komunale
6. Propozim ndryshimi i statutit të komunës se Drenasit
7. Propozim vendim për formimin e komisionit vlersues për dhënjën në shfytëzim të pronës se paluajtshme të komunës
8. Propozim vendim për kthimin e pronës komunale në zonen kadastrale në Sankoc të cilat i ka pasë kompania “Kodra”shpk në Komoran
9. Plani i integritetit 2018-2020

Prezentuan: Kryetari i Komunes z. Ramiz Lladrovci ,perfaqësues te KFOR-it, perfaqësues të OSCE-së si qytetar

Takimi filloi punimet në ora 10:00

LABINOT HALILAJ – Shpalli te hapura punimet e kesaj mbledhje i cili i njoftoj te pranishmit me rendin e dites dhe kerkoj nga të pranishmit se a pajtohen më këtë rend dite,

XHAVIT DRENORI-kerkoj sqarim nga kryetari pse nuk janë bërë ndryshimet që janë propozu në KPF-ca, e kam fjalën per rregulloren per taksa, rregullorja na ka ardh pa ndryshime e njejta si në KPF-ca,ju i keni prur edhe rekomandimet e kpf-ca ,dy propozime per te njejten qështje nuk janë me ardh, është e padrejt , askund nuk ka keshtu,unë kisha kerku që në rend dite të hyjë edhe pika të ndryshme se kemi mjaft me diskutu,unë kam një pyetje pse nuk ju vazhdu kontrata klubit futbollistik prishtina që lojtë ti luaj në stadiumin “Regjep Regjepi”

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-kerkoj që në rend dite të hyjë edhe pika të ndryshme që të kemi mundësin me diskutu qka juve u intereson

XHAVIT DRENORI-unë po kerkoj sqarim nga kryetari pse nuk ju vazhdu kontrata klubit futbollistik prishtina

LABINOT HALILAJ-z.Drenori ju edhe po kerkoni sqarim edhe po debatoni ,fillimisht ne duhet te percaktohem dhe ta votojmë rendin e dites e pastaj mundë te debatojmë një qështje e jo ende pa u aprovu rendi i dites ju po debatoni

SOKOL BYLYKBASHI-kerkoj nga kryesuesi pse nuk po respektohen ligjet bazike nga ana e juaj si kryesues, pse nuk po e thirrni mbledhjen e jashtëzakonshme që është kërkesa e 11 anëtrëve të Kuvendit pse nuk po e respektoni ligjin per vetëqeverisje lokale.

LABINOT HALILAJ-z.Bylykbashi fol per rend dite nese keni diqka mos dilni jashtë rendit të dites respektoni rregulloren e punes te Kuvendit

PERPARIM SHALA-unë kerkoj që në rend dite të hyjë per diskutim një kërkesë që e kamë bërë edhe ma heret e që është në interes të qytetarëve të fshatit fushticë,e cila kërkesë ka të bëjë me rrezikun që u kanoset ketyre banorëve nga shtyllat elektrike , veq sa nuk janë rrezuar dhe dita dites do të rrezikohen banoret ,ka levizje të nxënësve qdo ditë dhe ka rreshqitje të dheut per rreth ketyre shtyllave ku mundë të rrezikohet jeta e banorve në këtë fshat.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-unë kisha kerku që të gjitha keto kërkesa mundë ti diskutojmë në piken të ndryshme votoni rendin e dites e pastaj diskutojmë

BEQIR KIQINA-kerkoj nga kryetari që të bëhet një monitorim me i mirë per pastrimin e rrugëve nga bora që ka rënë keto ditë ,disa rrugë nuk janë duke u pastruar si duhet ne këtë rast Drejtoria e shërbimeve publike të jetë në mbikëqyrje të rrugëve.

LABINOT HALILAJ-kerkoj nga anëtarët e kuvendit që të respektohet rendi i dites dhe nese dikush ka ndonjë propozim konkret propozoni e jo të diskutoni ende pa u aprovu rendi i dites

SABRIJE KUKAJ-kryesues unë kerkoj që në rend dite të hyjë edhe pika të ndryshme dhe në këtë pikë mundë ti diskutojmë të gjitha ato qështje që po kerkohen nga ana e anëtarëve të kuvendit

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-te nderuar anëtarë të kuvendit ende rendi i dites nuk është aprovuar, pa u aprovu rendi i dites ne nuk mundë të debatojmë, per hirë të qytetarëve dhe mbledhjet janë duke u percjelur onlain kerkoj që fillimisht të aprovohet rendi i dites e pastaj te debatojmë ,unë jamë i gatshem per qkado që ju u interson te debatojmë nuk ju iki debateve por pa u aprovu rendi i dites ne nuk kemi qysh me debatu.

VEHBI BERISHA-kerkoj që për seancen e radhes të na vijë një informat se kah ka me kalu rruga me 4 korsi,ne si kuvend duhet të njoftohemi se neper cilat prona kalon kjo rrugë.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-nuk ka nevojë që mbledhjen e radhes me ju dhanë informatë, sot po ta japë pergjegjen për këtë pyetje që ju e parashtut,kjo rrugë krejt kalon neper prona shtetore askund nuk i prek pronat private,keto prona janë shpronësu qysh në vitin 1984

PETRIT SINANI-në vend që kjo seancë të filloj me një minutë nderim per të renet gjatë luftes ,ne ketu debatojmë ende pa u miratu rendi i dites,unë kisha kerku nga të gjithë anëtarët e Kuvendit të respektohet rregullorja e punës se kuvendit të aprovohet rendi i dites e pastaj vazhdojmë me diskutime,edhe unë kerkoj që në rend dite të hyjë pika të ndryshme.

BURIM BUJUPI-unë edhe në mbledhjen e komitetit per politik dhe financa kamë kerku që në rend dite të hyjë pika të ndryshme, por keto rekomandime nuk na kanë ardh,ne në kpf-ca kemi kerku që sa i perket pronave të na vijë edhe një raport per të gjitha pronat që shfytëzohen e nuk i kanë permbushë kontratat.

LABINOT HALILAJ-kerkoj perseri që të votohet rendi i dites e pastaj të vazhdojmë me diskutime

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADOVCI-unë po ju tregoj se sa i perket propozimit per kthimin e prones në sankoc është formuar një komision dhe me mujë ka punuar, deri sa ka konstatuar se kompania nuk i ka perfill kushtet e kontrates,edhe unë jamë per atë që qdo kompani që nuk i ka permbushur kushtet e kontrates, prona ti kthehet komunës kjo don kohë.

PETRIT GASHI-kerkoj që të votohet rendi i dites edhe me një pikë të ndryshme dhe kerkoj nga kryesuesi që të hidhet në votim rendi i dites.

NEXHMEDIN BALAJ-kerkoj që ndryshimet që bëhen në kpf-ca të merren per bazë, vendimet që janë diskutuar në kpf-ca kanë ardh në kuvend pa u ndryshuar,ndryshimet duhet të bëhen ashtu siq kerkon kpf-ca,unë kamë qenë anëtarë i komitetit per politik dhe financa dhe sa herë që ne kemi kerkuar ndryshime ato janë bërë dhe vendimet në kuvend kanë ardh me ndryshime.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-i nderuar z.Bala ti po e mohon punen tande kater vjeqare,shumirë e dini që komiteti per politik dhe financa nuk merr vendime ,japë rekomandime, vendime merr Kuvendi, ju sot vendosni,jo komiteti per politik dhe financa,dhe gjithëher fillimisht hidhen në votim propozimet e Kryetarit e pastaj propozimet e komitetit per politik dhe finaca apo ndonjë propozim tjetër prej anëtarëve të Kuvendit.

XHAVIT DRENORI-edhe në komitet per politik dhe finaca të gjitha propozimet kalojnë me vota duhet të respektohen vendimet e komitetit për politik dhe financa

LABINOT HALILAJ-hodhi në votim rendin e dites edhe me një pikë shtesë të ndryshme:

Më rastin e votimit prezent ishin:30 anëtarë:

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:30,kunder 0,dhe abstenim0

LABINOT HALILAJ-hapi diskutimin për piken e parë të rendit të dites

1. Proces verbali i dt: 30.01.2018

PETRIT GASHI-kerkoj që në faqen 6 të këtij procesi të ndryshohet ku është cek largësia e një tregu te kafsheve prej vendbanimit është 2000 m, unë kamë thënë sipas standardeve dhe kriterëve evropiane duhet të jetë 500deri në 1000m largësi nga vendbanimet.

KRYETARI I KOMUNES RAMIZ LLADROVCI-ky vendim i BERZHIT nuk rrjedh nga dita e takimit që ne kemi pasur, kjo është në vazhdimësi, ne kemi propozuar edhe projekte tjera rast konkret përmendi projektin për impiantin e ujërave të zeza si dhe projektin e digës në Verboc, projekte të cilat do të jenë prioritet dhe do të kemi perkrahjen nga qeveria dhe bashkësia europiane

LABINOT HALILAJ-kërkoj që të respektohet rendi i dites duke marrë parasysh se kjo mbledhje sot është e tejzgatur dhe shumë e lodhshme

VEHBI BERISHA-parimisht jemi kunder ketyre ndryshimeve statutare dhe kunder shtuarjes së dy drejtorive në Komunen e Drenasit

SHQIPE ZOGU-ne i mirëpresim keto ndryshime statutare dhe jemi për, prandaj vetem le të zhvillohen procedurat tjera ligjore

PETRIT SINANI-kërkoj që në këtë rast fjalën ta marrë krytarja e këtij komisioni të zgjedhur nga ekzekutivi Flutura Avdiu të na njoftoj për punën e komisionit deri më tani, por në këtë rast unë kisha kërkuar që ky komision të plotësohet edhe me anëtarë nga Kuvendi i Komunes

SHQIPE ZOGU-kërkoj që kuvendi të përfaqësohet në këtë komision me dy anëtarë

XHAVIT DRENORI-propozoj që të jenë 4 anëtarë nga kuvendi

LABINOT HALILAJ-fillimisht hodhi në votim propozimin e Shqipe Zogut që në këtë komision kuvendi të ketë dy anëtarë: me rastin e votimit prezent ishin 30-anëtarë, për votuan 21, kunder 06, dhe abstenim 03

LABINOT HALILAJ-kerkoj nga kuvendi që të shkojm me propozime për zgjedhjen e dy anëtarve për komisionin e ndryshimeve në statut:

ADEM BUCOLLI-propozoj Shqipe Zogun

BURIM BUJUPI-propozoj Vehbi Berishen

XHAVIT DRENORI-propozoj Beqir Kiqinen

KRYETARI I KOMUNES RAMIZ LLADROVCI-pasi që janë propozuar tre anëtarë të kuvendit votimi duhet të jetë i fsheht dhe në këtë rast duhet ta zgjidhni një komision për të punuar dhe percjell këtë votim për zgjedhjen e dy anëtareve apo mund ta bejnë ndonjë marreveshje anëtarët e propozuar

VEHBI BERISHA-deklaroj publikisht se terhiqem nga ky komision me vetëdëshirë dhe po ju jap perparsi dy kandidateve tjerë të propozuar

LABINOT HALILAJ-hodhi në votim propozimin që Shqipe Zogu dhe Beqir Kiqina të jenë pjesë e komisionit për ndryshime të statutit, me rastin e votimit prezent ishin 30 anëtarë;për votuan 30,kunder 00 abstenim 00

LABINOT HALILAJ- hapi diskutimin për piken e 7 të rendit të dites:

7.propozim vendimi për formimin e komisionit vleresues për dhënien e pronave në shfrytëzim të prones se palujtshme komunale

KRYETARI I KOMUNES-RAMIZLLADROVCI-i njoftoj anëtarët e kuvendit se komuna është e obliguar që në fillim të mandatit të formojnë një komision për vlersimin e dhënjes se pronave në shfytëzim ku ky komision duhet të ketë 7 anëtarë tre anëtrë nga ekzekutivi,tre anëtrë duhet të zgjidhen nga kuvendi dhe një anëtarë i këtij komisioni duhet të jetë i caktuar nga biznesi,kerkoj nga kryesuesi që të shkoj me propozime për anëtarë të këtij komisioni nga ana e kuvendit.

LABINOT HALILAJ-kërkoj nga anëtarët e kuvendit që të shkojmë me propozime konkrete duke filluar nga grupi me i madhë në kuvend pdk-ja:

SHQIPE ZOGU-nga pdk-ja propozon:z.Qendrim Mulaj,Nexhmedin Balaj propozon nga nisma znj.Sabrije Kukaj,Burim Bujupi propozon Petrit Gashin,ndersa Xhavit Drenori në emer të vizionit ,aak-së dhe vv-jes për këtë komision propozoi z.Sokol Bylykbashi

PETRIT SINANI –perkrahu propozimin e Burim Bujupi që Petrit Gashi të jetë pjesë e këtij komisioni,

SOKOL BYLYKBASHI-deklaroj se unë terhiqem me vetë dëshirë nga ky komision

BEQIR KIQINA –propozoi Fitore Morina të jetë kandidate për këtë komision

LABINOT HALILAJ-kerkoj nga kuvendi që ta formojmë një komision për verifikimn dhe zgjedhjen e këtij komisioni me vota të fshehta pasi kemi të propozuar kandidat më teper se tre anëtarë;

Anëtarë të komisionit për numrim të votave u propozuan:Bekim Lestrani Petrit Sinani dhe Florentina Elezi

FLORENTINA ELEZI-në emer të komisionit ftoj të gjithë anëtarët prezent një nga një për të votuar;më rastin e votimit prezent ishin 30 anëtarë,më shumicë votash anëtarë të këtij komisioni u zgjedhen:Qendrim Mulaj Sabrije Kukaj dhe Petrit Gashi

LABINOT HALILAJ-hodhi në votim këtë propozim vendim për zgjedhjen e komisionit për vlersim të dhënjes se prones se paluajtshme komunale;më rastin e votimit prezent ishin 30 anëtarë,votuan për:30 anëtrë-kunder-0 dhe abstenim-0

LABINOT HALILAJ-hapi diskutimin për piken e tetë të rendit të dites:

8.propozim vendimi për kthimin e pronës që kishte në shfytëzim kompania"Kodra"nga Komorani në pronë komunale.

MILAIM HAJDARI- i njoftoj anëtarët e kuvendit se ne ju kemi ofruar propozim vendimin për kthimin e pronës në Sankoc në pronë komunale,duke marrë parasysh se kompania që ka pasë në shfytëzim këtë pronë nuk i ka perfill kushtet e kontrates

,këtë e ka konstatuar një komision prej 7 anëtaresh i zgjedhur nga kryetari i Komunës,ne si komunë jemi të obliguar që prona ti kthehet Komunës

PERPARIM SHALA-sa i perket këtij propozim vendimi ne nuk jemi te informuar sa duhet ,është dashtë që ne të kemi edhe material shtesë te bashkangjitur në këtë propozim vendim,ti dimë vrejtjet e komunës,të jemi te njoftuar se kompania i ka kry apo nuk i ka kry obligimet ndaj komunës,dhe duke u bazuar në këtë propozim që sot nuk është i kompletuar kerkoj që të kompletohet e pastaj ta diskutojmë ne seancat e radhes.

NEXHMEDIN BALAJ-është fakt se në legjislaturen e kaluar kemi dhanë një numer të pronave komunale në shfytëzim,unë jamë që të gjithë ata që kanë perfituar dhe i kanë në shfytëzim pronat dhe nuk i permbushin obligimet sipas kontrates prona ti kthehet komunës jo vetëm ky rast që sot na ka ardh,sot nuk kemi material të mjaftueshem që të diskutojmë per deri sa nuk na vjen një raport i pergjithshem për të gjitha pronat ne nuk e perkrahim vetem këtë propozim vendim.

XHAVIT DRENORI-më vjen mirë qe ne sot na ka ardh një propozim vendim per kthimin e prones komunale,sikur te na kishte ardhë një raport per të gjitha pronat që janë dhënë gjatë vitit 2014-2015,ku shumë prej tyre nuk i kanë permbush obligimet sipas kontrates dhe nuk e kanë perfill planin dinamik të caktuar prej 18 muajve,jamë i paknaqur me vonesen,ne jemi të obliguar më e ruejt pronen komunale,ne nuk guxojmë të marrim vendim vetëm per një pronë ku kemi edhe shumë prona tjera të uzurpuara ,rast konkret permendi zyret që ka uzurpuar pdk-ja ,unë kerkoj që sa i perket kësaj qështje të formohet një komision nga kuvendi që të merret me verifikimin e të gjitha pronave dhe të vertetoj gjendjen faktike e jo të na vijë ne vetëm një propozim vendim vetëm për një pronë.

SOKOL BYLYKBASHI-të nderuar rasti i kompanisë kodra është rasti më i rendë dhe krimi më i rëndë që i ka ndodhur Komunes se Drenasit ,qysh në atë kohë kamë qenë kunder dhe i kamë njoftu kuvendin se jeni duke bërë shkelje,e gjithë kjo ka filluar në vitin 2012 kur drejtorati për bujqësi ka lëshuar një pelqim të jashtëligjshem ,dhe pas ankesave të disa qytetarëve ne kemi bërë një kallëzim penal,propozimi i parë kur ka ardhë unë kamë kerku që të mos votohet nuk me kanë ndegju kemi vepru jashtë ligjshem ,kjo kompani jashtëligjshem ka perfitu milionat,pastaj ka ardhë propozimi i dytë ,perseri kamë kerku që të mos votohet perseri është votu dhe kjo kompani ka vepru jashtëligjshem perseri ,une e kamë lëshuar mbledhjen dhe nuk kamë ndejt fare në sallë kur është votuar per dhenjen e kësaj prone.është e vertetë që ka shkelje nga kjo kompani sepse ka shfytëzu pronen pa të drejtë,unë jamë për këtë propozim vendim por pse nuk keni filluar prej zyreve të pdk-së që janë të uzurpuara e të shkojmë në menyre gjenerale e jo individuale,

XHAVIT DRENORI-unë e shohë të arsyeshme dhe kerkoj që të formohet një komision nga kuvendi që të verifikoj të gjitha pronat e jo në menyre individuale të shkojmë.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-qdo pronë që e japë Kuvendi ka per obligim të menagjon Ekzekutivi,për këtë qëllim ne kemi formuar një komision prej 7 anëtaresh ku ka dalë në teren dhe ka konstatu se kompania kodra që ka marrë në shfytëzim pronen komunale nuk e ka respektuar kontraten dhe ne jemi të obliguar tja nderprejm kontreten dhe e kemi pru propozimin në kuvend që kjo pronë ti kthehet komunës,kur ka shku komisioni në teren ka gjetë ë punë vetëm 3 punëtorë ,ndersa sa i perket zyreve të uzurpuara të pdk-së kjo qështje është nenhetim dhe une nuk e shkel ligjin,kur të vendos hetuesia atëherë ne merremi më këtë qështje.ne per prona komunale kemi pasë edhe rastin kur u plagos polici fadil shishani ,sepse janë bërë fallsifikme të prones,nuk është mirë që në këtë rast të permendëet emri i bislim zogajt ,kurgja nuk kamë me bislimin,kontrat është në emer të tjetër kujt por ne jemi të

obliguar të mbrojmë pronen komunale,ligji na obligon,komisioni ka konstatu se kompania kodra nuk i ka permbush obligimet që ka pasë sipas kontrates dhe ne e kemi prurë propozimin për kthim të kësaj prone dhe kerkoj nga kuvendi që ta votoj këtë propozim vendim.

XHAVIT DRENORI-unë pajtohem nese na vjen një raport për të gjitha pronat edhe njëher po kerkoj që të formohet edhe një komision prej kuvendit dhe se bashku edhe me komisionin e ekzekutivit të verifikojn të gjitha pronat se a ju kanë permbajtë kushteve të kontrates apo jo.

BEQIR KIQINA-unë jamë i lumtur që po ju jepet shpresë qytetarëve,unë jamë pro këtij propozimvendimi,unë ju pergezoi që prona komunale ti kthehet komunës,pdk-ja është zhvatësi me i madhë i prones komunale,e në këtë rast nuk është vetëm Bislim Zogaj që ka keqëperdor pronen komunale, ka edhe persona tjerë të pdk-së që kanë keqëperdor dhe kanë pronë komunale, flitet për Shaip Mujen,Ferat shala e persona tjerë që shfytëzojnë jashtëligjshem pronen komunale dhe perfitojnë milionat duke keqëperdor dhe krijuar monopol.unë në këtë rast jamë me z.Lladrovci që nese edhe prindi keqëperdor pronen unë jamë kunder tijë ne këtë rast,por kerkoj nga kryetari që të merret edhe me pronat tjera e jo vetëm më këtë rast,në keto raste duhet paguar edhe demshperblimin.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI- unë kisha kerku nga ju që ti permbaheni rendit të dites dhe nuk është mirë te permendni emra ketu,e permendet Shaip Mujen,se është duke keqëperdor pronen komunale,nese ju e dini sakt se ku është duke keqëperdor pronen ju kisha lut të me tregoni unë do të marrë të gjitha masat në bazë ligjore, por unë nuk e di se ka dikund pronë në emer të tijë,edhe për secilin që keqëperdor pronen komunale ose ka uzurpuar unë do të marrë masa kushdo që është edhe vlla i jemi nese është do të veproj ne baza ligjore.

PETRIT SINANI-unë kerkoj të respektohet rendi i dites ne raste të tilla siq po e diskutojmë sot këtë propozim vendim mirë është ti bashkangjiten edhe dokumenta tjera dhe ne ta dimë se qka po votojmë .

PETRIT GASHI-ne qysh në vitin 2013 kemi qenë të njoftuar se prona në sankoc është duke u keqëperdor,është bartë zhavor që nuk ka qenë e drejtë por për gjithë këtë fajtor është kuvendi që e ka votu, ku ka këtu anëtarë në këtë kuvend që e kanë votu, keni pasë mundësi me e ndalu nuk e keni ndalu,iqd-ja është për kthimin e prones komunale ,dhe perkrah edhe të gjitha pronat tjera komunale të kthehen nese kompanitë nuk kanë perfill kushtet e kontratave.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-asambleistet mundë të votojnë sipas dëshires se tyre,kjo nuk ka ndodhë vetëm për këtë pronë,ka pasë edhe raste tjera që është vepru në këtë menyre,unë nuk them që kuvendi ka bërë krim qe dikush e tha më heret por kuvendi është qitë në lajthitje ne kemi edhe rastin e stacionit të autobusëve që është votu nga kuvendi .

XHAVIT DRENORI-nuk është mirë ne që kemi qenë anëtarë të kuvendit me na etiketu, se nuk e kemi ndalu në atë periudhë, mos dhenjen e pronave , se ne kemi bërë shkelje, kjo nuk qendron,unë kamë qenë shumë i zhurmshem dhe e kamë kundërshtuar më këmbëngulje dhenjen e kësaj prone dhe nese dikush e ka luftu me se shumti mosdhenjen e kësaj prone ne kuvend jam unë,nuk është e vertetë që unë e kamë perkrah apo votuar,unë kamë qenë kunder.

VEHBI BERISHA-gjithëmon është manipulu me pronat në Drenas nga të njejtat njerzë SABRIJE KUKAJ-unë kamë qenë pjesë e këtij komisioni,ne si komision kemi punuar në bazë të kriterëve që kanë qenë të parapra me ligj,ne si komision propozimet tona i kemi prurë në kuvend,janë hedhë në votim janë votu ,kuvendi është organi me i lartë i komunës që ka vendos për keto prona, sa i perket rastit kodra unë po ju njoftoj se

edhe pse kamë qenë pjesë e këtij komisioni nuk e kamë votuar,unë nuk jamë kunder që të vijë një raport për të gjitha pronat që janë dhënë në shfytëzim,por pse nuk po merrni më uzurpimet të pronave , per qdo ditë i shohim dhe e dimë si i kanë uzurpuar pronat, dhe nuk merrni kurrëfarë masash, rast konkret e kemi komorantin, sa shtepit janë ndertu në atë zonë, dhe askush nuk ndermerr kurrëfarë masash unë jamë që kudo ku ka pronë komunale të uzurpuar ti kthehet komunës,është dikund një pronë që e ka uzurpuar jolla kamë ndegju se nuk e di as kush është.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-unë nuk e di se ku e ka jolla atë pronë nese ju e dini më tregoni,në komoran ka edhe drejtoresha uzurpim,mvjen keq që po e permendi,por ne kemi edhe shumë prona tjera e askush nuk ka dhene llogari per këtë i vetmi ka qenë qe ka marrë denim bashkëshorti i drejtoreshes,por unë nuk kamë shku në menyrë selektive, unë edhe njeher po ju them se nuk kamë asgjë me z.bislim zogaj,por unë e kamë qëllimin që kudo që ka pronë komunale do të perpiqem që tia kthej komunës,ne veq jemi në muajin e tretë edhe në muajt ne vazhdim ne do ti verifikojmë pronat se a janë permbush kushtet e kontrates nese nuk janë permbush ne pronen do tia kthejmë komunës,unë për këtë qëstje kamë bisedu me enver zogajn para se me ardhë ky propozim vendim e kamë njoftu per këtë qëstje,dhe ne jemi duke folur per kompani e jo per emra.

ARTA GJYLANI-unë kisha kerku që kjo kompani të veprojm tash sipas ligjit të ri që pritet të hyjë në fuqi,se ne kemi prona në komoran që shfytëzohen dhe janë ne borgje e nuk paguajnë dhe nuk ndërmerret asgjë

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-sa i perket ketij ligji ne tri ditë e kemi diskutu kur ka qenë në diskutim dhe sipas ketij ligji 20%duhet ti bëhet pagesa komunës në këto raste,unë sot kamë pru vetëm këtë propozim vendim ,por mbledhjeve të radhes unë do ti sjell edhe propozimet tjera per kthim të prones aty ku nuk janë perfill kontratat,per rastin e kompanisë kodra unë ju thash kamë bisedu me enverin edhe ai vetë e ka pranuar se nuk e ka permbush kontraten si është e nenshkruar,ne i kemi te gjitha deshmit kur ka pagu e kur jo e një kompani që nuk i permbush obligimet ndaj komunes ne jemi të obliguar tja nderpresim kontraten,e në këtë rast kompania kodra nuk i ka permbush obligimet dhe ne kemi propozu që kjo pronë ti kthehet komunës.

ARTA GJYLANI-pse nuk e sjell zyrtarin per minim ketu .është model per studenta te cilet i kanë percjell punimet dhe është shembull në nivel vendi ,keto janë arsyetime gjysmake,

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-kompania kodra ka licensë deri me 2019 -ten,unë kamë qenë vetë në kontroll .ka punu pa minim vetëm per të ikur shpenzimeve,unë vetë kamë qenë e kamë inqizuar në vend,terenin

ARTA GJYLANI-a po hynë pronat komplet ti japim hapësirë duke u nisur nga shtepit ,banesat e keshtu me radhë,

BURIM BUJUPI-më vjen mirë që ka ardh një propozim vendim për pronat komunale,na si nismë jemi që në kuvend te na vijë një raport për të gjitha pronat të cilat nuk ju kanë permbajtur kushteve sipas kontratave,dhe keto prona ti kthehen komunës,është fakt që kompania kodra e ka degraduar atë vend atje,unë edhe në KPF-ca kamë kerku një raport për të gjitha pronat,

LABINOT HALILAJ-hodhi në votim këtë pikë të rendit të dites:më rastin e votimit prezent ishin 31 anëtarë:votuan për:27,kunder 1 dhe abstënim 1

LABINOT HALILAJ-hapi diskutimin per piken e 9 të rendit të dites:

9.plani i integritetit

XHAVIT DRENORI-kerkoj nga kuvendi që pika e 10 të ndryshme të shtyhet për mbledhjen e radhes per shkak se mbledhja është zgjatur shumë ,dhe në mbledhjen e radhes pika të ndryshme të jetë si pikë e parë e rendit të dites:

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI –pajtoj edhe une që kjo pikë e rendit të dites të shtyhet për mbledhjen e radhes

LABINOT HALILAJ- kerkoj nga anëtarët e kuvendit se a pajtohen që kjo pikë te ndryshme të shtyhet per mbledhjen e radhes per të cilen gjë u pajtuan të gjithë anëtarët prezent.

LABINOT HALILAJ-kerkoj që të vazhdojmë më piken e nëntë të rendit të dites a ka dikush diqka për të diskutuar,pasi që nuk pati diskutime:


LABINOT HALILAJ –hodhi në votim këtë pikë të rendit të dites:më rastin e votimit prezent ishin 31 anëtarë:rezultati i votimit ishte si vijon:për 31,kunder 0 dhe abstenim 0 .

LABINOT HALILAJ- mbylli këtë seancë rreth ores:21:30 minuta

Proces mbajtësi

Xhavit Nebihi



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT

KUVENDI I KOMUNES



12 Nr. 06/01 - 35128 dt. 20/06/2018

**Mbledhja e rregullt
Kuvendi Komunal
29.03.2018**

PROCESVERBAL

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më
dt.29.03.2018

Mbledhjen e kryesoi **LABINOT HALILAJ** – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të rregullt të Kuvendit Komunal ku të pranishëm ishin 31 anëtarë

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Proces verbali i mbledhjes të dt.01.03.2018
2. Propozim vendimi për shpalljen e Pandeli Majko "Qytetar Nderi"i Komunës së Drenasit
3. Propozim vendimi për shpalljen e Ëalburga Habsburg Douglas "Qytetare Nderi" e Komunës së Drenasit
4. Raporti i punës i Kryetarit të Komunës për vitin 2017
5. Propozim vendimi për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës nr.463-34434 të dt.20.06.2016, në ngastren kadastrave 726/15 në zonën kadastrave në Drenas, që i ishin dhënë në shfytëzim kompanisë "Valdrin" SHPK.
6. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës 12nr.353-12312 të dt.04.03.2015, në zonën kadastrave Korroticë e Ulët
7. Propozim vendimi për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës 12nr.351-183 të datës 31.12.2004, në ngastrën kadastrave 144/2 në

- Polluzhë, që i ishin dhënë në shfrytëzim Kompanisë "Hitchenergy Kosova" me pronar Ali Kastratin nga Polluzha.
8. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës 12 nr.463-16568 të dt.25.03.2015,në ngastrën kadastrave 295/1në Sankoc, që i ishte dhënë në shfrytëzim Rashit Rashiti nga Sankoci.
 9. Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2017
Propozim vendimi për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike "Pastrimi"
 10. Formimi i komisionit për zgjedhjen e këshillave nëpër fshatra dhe vendbanime urbane
 11. Propozim vendim për emërimin e bibliotekës së qytetit të Drenasit më emrin "Ymer Elshani"
 12. Zëvendësimi i anëtarit të Komitetit për politik dhe financa dhe zëvendësimi i anëtarit të komitetit për komunitete
 13. Propozim për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të Komunës
 14. Të ndryshme:

Prezentuan: Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovci, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të OSCE-së dhe përfaqësues të mediave .

Takimi filloi punimet në ora 13:10

LABINOT HALILAJ –përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i falënderoj të gjithë për prezencën e tyre, në këtë rast kërkoj nga anëtarët e kuvendit a pajtohen më këtë rend dite apo keni edhe ndonjë propozim:

XHAVIT DRENORI –para anëtarëve të Kuvendit dha dorëheqje prej anëtarit të Kuvendit dhe në këtë rast lexoj deklaratën e dorëheqjes, këtë deklaratë e ka dorëzuar me shkrim ku keni të bashkangjitur me proces verbal.

SABRIJE KUKAJ-sa i përket pikës së 12 të rendit të ditës unë kisha kërkuar që kjo pikë të shtyhet për një mbledhje tjetër të radhës, në legjislaturën e kaluar i kemi pas dy propozime për emërtimin e bibliotekës së qytetit sot e kemi vetëm një propozim

LABINOT HALILAJ-komiteti për politikë dhe financa ka rekomandua që të vijë ky propozim-vendim në kuvend.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-është e vërtetë se ne legjislaturën e kaluar i kemi prurë dy propozime në kuvend për emërtim të bibliotekës së qytetit por unë i kam sjellë të dy propozimet se ne i kemi pas dy kërkesa dhe ju si kuvend keni kërkuar që të na vijë vetëm një propozim në kuvend, e tash kemi një propozim ka propozua Florentina Elezi komiteti ka rekomandua me ardhë për kuvend dhe ne kemi përgatit propozim vendimin.

NEXHMEDIN BALA-kërkoj që pika e gjashtë(6) e rendit të ditës të hiqet pasi kjo lëndë është në gjykatë dhe nuk kemi të drejtë të marrim vendim për këtë çështje

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-ky propozim ka ardhë në kuvend duke marrë për bazë se është dhënë jashtë ligjshëm, nuk kanë pas të drejtë në komasacion të ndahet parcela nën një hektar,pastaj diferenca e vlerës së pronave ku është bërë këmbimi ndryshon shumë është vlerësua prona njëjtë sikurse aty ku është vlera

200,300 po edhe 800 euro sikurse ku i është dhënë prona që ka vlerë prej 5.000 euro e deri në 10.mijë euro për ari nuk janë zhvillu procedurat sipas ligjit unë kërkoj që të mos hiqet nga rendi i ditës kur ti vjen radha diskutojmë për këtë pikë të rendit të ditës

PETRIT SINANI-kërkoj që të shkojmë me votim për rendin e ditës e pastaj diskutojmë për secilën pikë të rendit të ditës një nga një.

SHQIPE ZOGU-kërkoj që fillimisht të hidhet në votim rendi i ditës siç ka ardhë prej ekzekutivit e pastaj nëse nuk votohet shkojmë votim me propozimet që u dhanë nga anëtarët tjerë të kuvendit

BEQIR KIQINA-kërkoj që të mos ngutemi të votojmë se është përgjegjësi ligjore nese ne marrim vendime për një vendim që është në procedurë nëpërmes gjykatës, edhe unë jam që pika 6 të hiqet nga rendi i ditës.

LABINOT HALILAJ-atëherë shkojmë më votim se a jeni për këtë rend dite: Më rastin e votimit prezent ishin 28 anëtarë: rezultati i votimit ishte si vijon:Për 17, kundër 8 dhe 3 abstenime

LABINOT HALILAJ-hapi diskutimin për piken e parë të rendit të ditës:

1. Proces verbali i mbledhjes të dt.01.03.2018

LABINOT HALILAJ-hapi diskutimin për proces verbalin e datës 31.08.2017

pasi që nuk pati vërejtje dhe diskutime rreth këti proces verbali

ENDOLINA PLAKIQI-kërkoj që të plotësohet ky proces në faqen 8 kur propozimet janë dhënë nga grupi i AAK-së ku behet fjalë për rregulloren për taksa

LABINOT HALILAJ-hodhi në votim proces verbalin e dt.31.08.2017 me ndryshime Më rastin e votimit prezent ishin 31 anëtarë:

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:31

Kundër:0

Abstenim:0

LABINOT HALILAJ-i njoftoj anëtarët e Kuvendit të komunës më piken e dytë të rendit të ditës:

2.Propozim vendimi për shpalljen e Pandeli Majko "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit

SHQIPE ZOGU-grupi parlamentar i PDK-së i përkrah dy propozimet për shpalljen qytetar nderi të Drenasit që ka sjellë kryetari,por unë edhe vitin e kaluar po edhe sot po kërkoj që për këtë çështje herëve tjera të formohet një komision për hartimin e një rregullore në mënyrë që të përcaktohen kriteret se kujt dhe kush mundë të dekorohet.

SOKOL BYLYKBASHI-para se të flasim për këto dy propozime që kanë ardhë për shpalljen qytetarë nderi të komunës sonë, unë kam vërejtje në kryetarin se çështjen e mirënjohjeve më shumë është duke e përdorur për qëllime politike, ka shpërndarë rreth 2.000 mirënjohje kjo vetëm e degradon këtë çështje dhe nuk i banë nderë askujt unë jam për këto dy propozime por nuk pajtoj që të ndahen mirënjohje e dekorata pa pasur një arsye se për çka po i ndahet dhe kujt.

PETRIT GASHI-ne si iniciativë qytetare e Drenasit i përkrahëm këto dy propozime për shpallje qytetarë nderi të Drenasit, ne e dimë të gjithë se sa ka dhënë kontribut ish kryeministri shqiptar z.Pandeli Majko gjatë luftës në Kosovë kontributi i ije është i padiskutueshëm dhe kontributi i tije ka qenë i jashtëzakonshëm, gjithashtu edhe propozimi tjetër për shpalljen qytetare nderi Ëalsburg Habsburg Douglas e meriton një gjë të tillë, gjatë gjithë periudhave të historisë kjo familje e këtij shteti na ka përkrahur dhe kanë dhënë një kontribut të veçantë për shqiptarët në përgjithësi prandaj unë i përkrahu të dy propozimet.

BEQIR KIQINA-unë si anëtarë i kuvendit dhe në këtë rast si përfaqësues i AAK-së përkrahu këtë propozim për shpalljen qytetarë nderi të Komunës së Drenasit z.Pandeli Majko, kjo vetëm i bënë nderë Komunës, ne e dimë se z.Pandeli Majko gjatë periudhës së luftës në Kosovë gjatë viteve 1998-99 ai ka qenë Kryeministër i Shqipërisë dhe në këtë periudhë ka dhënë një kontribut të veçantë në përkrahje të popullit të Kosovës dhe është një nder figurat shqiptare që me se shumti i e meriton këtë mirënjohje

PETRIT SINANI-sa i përket këtij propozimi për shpalljen qytetarë nderi të ish Kryeministrit Shqiptar z.Pandeli Majko unë mendoj se ne duhet të jemi shumë të nderuar kur ai pranon një dekoratë nga komuna jonë që të shpallet qytetarë nderi i komunës sonë, unë e përkrah këtë propozim

NEXHMEDIN BALA-gjithashtu edhe ne përkrahim këtë propozim vendim që z.Pandeli Majko të shpallet qytetarë nderi i Komunës së Drenasit është një figurë që e meriton një gjë të tillë.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-ju falënderoj të gjithëve për përkrahjen dhe diskutimet e juaja dhe në këtë rast kërkoj nga Kryesuesi që ta hedhë në votim këtë propozim-vendim.

LABINOT HALILAJ-hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës:

Më rastin e votimit prezent ishin:29 anëtarë,për votuan 27 anëtarë, kundër 02 dhe abstenim 0

LABINOT HALILAJ-hapi diskutimin për pikën e tret të rendit të ditës

3.Propozim vendimi për shpalljen e Ëalburga Habsburg Douglas "Qytetar Nderi" e Komunës së Drenasit.

PETRIT GASHI-unë e përkrahu këtë propozim vendim për shpalljen qytetarë nderi të Ëalburga Habsburg Douglas, është nderë që ne shpallim qytetare nderi një familje që gjatë gjithë periudhave historike na ka dhënë përkrahje në rrugëtimin e shqiptarëve, kanë publikuar fakte për shqiptaret kudo që janë dhe kanë dhënë një kontribut të veçantë për shqiptaret, prandaj unë e përkrahu dhe mbështes fuqishëm këtë propozim vendim kjo familje meriton një çmim të tillë dhe është nder për Komunën e Drenasit.

LABINOT HALILAJ- hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës:

Me rastin e votimit prezent ishin 29 anëtarë

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:29

Kundër:0

Abstenim:0

LABINOT HALILAJ-hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës

4.Raporti i punës i Kryetarit të Komunës për vitin 2017

SOKOL BYLYKBASHI-si zakonisht këtij raporti i mungon lista e projekteve kapitale dhe kërkoj nga drejtoria e urbanizmit që këtij raporti herëve tjera ti bashkëngjitet edhe lista e projekteve kapitale, të jemi më të informuar se cilat projekte kanë përfundua e cilat jo, nuk kemi as çka të diskutojmë kur këtij raporti i mungon kjo listë

VEHBI BERISHA-ky raport me tepër i ngjanë një raporti teknik se sa i punës, siç tha edhe kolegu ma herët, mungon lista e projekteve kapitale ne nuk e dimë saktësisht se çka në fakt është krye e çka jo, unë jam i interesuar me ditë se çka në të vërtetë po bëhet me projektet si Drenasi i ri që ka mbet ky projekt i papërfunduar, si projekti i ujësjellësit është fjala për bazenat në Kamenicë që 14 fshatra presin më padurim përfundimin e këtij projekti, a u vjen fundi ndonjëherë këtyre projekteve që përmenda

apo jo, pastaj kam vërejtje në subvencionimin e klubeve sportive janë përgjysmë subvencionet në ndihmë për klubet sportive.

BURIM BUJUPI-kërkoj sqarim nga drejtoria e kulturës, rinisë dhe sportit pse nuk u mbajte turniri në futboll të vogël "Rasim Kiqina" dy herë është përpjekë me u organizua dhe dy herë ka dështuar, kur dihet që ky turnir është nder turnirët me të mëdha në Kosovë që mbahet dhe ka interesim për këtë

PETRIT GASHI-unë i kam përcjellë edhe raportet tjera të mëhershme, ky raport ka përmirësime por ende ka nevojë për përmirësime, është dashtë që projektet të specifikohen se cilat projekte janë krye e cilat jo, por në këtë rast unë kam një pyetje se deri ku kanë përfunduar procedurat për ndërtimin e shkollës profesionale në Komoran dhe nëse procedurat janë krye kur pritet që ky projekt të filloj

BEQIR KIQINA-është një raport voluminoz, nuk janë dhënë detaje se çka është krye në fakt e çka jo prej projekteve, sa i përket turnirit tradicional "Rasim Kiqina" kisha thanë që të diskutojmë të pika të ndryshme, e sa i përket buxhetit nuk mund të themi se qëndrojmë mirë kur janë mbet mbi gjysmë milionë mjete pa u shpenzuar, por unë kisha kërkuar që këto gabime të vitit 2017 të mos përsëriten në vitin 2018.

SABRIJE KUKAJ-unë kam pyetje për drejtorinë e urbanizmit, sa mjete të humbura ka komuna prej grandeve se në raport unë nuk po shoh se janë cek dikund, dhe pyetja tjetër çka është duke u bërë me shtratin e lumit Drenica si dhe projektin e ujësjellësit kur do të përfundojnë këto projekte

PETRIT SINANI-unë kisha kërkuar se kudo ku janë paraqitur të dhënat në mënyrë tabelore të të gjitha drejtorit të shtohet edhe një kolonë të dihen të dhënat se sa është realizua buxheti, pastaj me siguri është gabim teknik por të përmirësohet në raport është fjala të vlera që është paraqitur për turnirin "Rasim Kiqina" është e dyfishuar, si dhe të dhënat e zyrës se auditorit thuhet se gjithçka është në rregull, duhet të ketë një raport më të detajuar e jo në këtë formë.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-do të përpjekem tu japë përgjigjet për pyetjet që i parashtuarat dhe në këtë rast për të gjitha sugjerimet që ju i dhatë unë i kam parasysh, pati pyetje se ka zvogëlim të subvencioneve për sportin, po është e vërtetë por ne veç i kemi rritë subvencionet se në këtë vit i kemi ndihmuar me bursa studentet kanë marrë bursa me tepër se 106 student, dhe për këtë veprim duhet të jeni falënderues, sa i përket mos mbajtjes se turnirit "Rasim Kiqina" askush nuk po e flisni të vërteten ka qenë ramazan dhe për këtë arsyes edhe nuk është mbajtur, por këtë vit do ta mbajmë këtë turnir, dikush pati pyetje se sa është realizua buxheti në realizim të projekteve kapitale, projektet janë realizua mbi 99%, kemi një projekt në Gjurgjicë që me fajn e punë kryesit është ndërprerë kontrata, projekte tjera nuk ka, e sa i përket pyetjes për shkollën profesionale se kur pritet me fillua po ju njoftoj se të gjitha procedurat kanë përfunduar vetëm me përmirësimin e kohës punimet do të fillojnë, sa i përket shtratit të lumit është projekt i ministrisë se planifikimit hapësinor por pritet me vazhdu punimet por ne kemi edhe shumë projekte tjera që BERZH-i do të investoj dhe do të na përkrahë, gjithashtu pritet që edhe projekti i ujësjellësit të përfundojë se shpejti, sa i përket pse lista e projekteve nuk është në raport ne jemi përpjekur që raporti të jetë sa më i qartë, e listën e keni të publikuar edhe në faqe të komunës dhe keni mundësi secili prej jush me e shikua.

BURIM BUJUPI-pyeti se ku kanë mbet mjetet që i kanë paguar disa ekipe vitin e kaluar për turnirin "Rasim Kiqina" dhe nuk janë kthyer, si dhe sa i përket subvencionimit të klubeve sportive e në këtë rast subvencionimi i klubit të Feronikelit kryetari ka thënë se mbi 50% nuk e subvencionoj asnjë klub, ndërsa këtu po del se klubi i Feronikelit do të paguhet mbi 60% te mjeteve që janë të parapara për

subvencionimin e klubeve sportive, ndersa i janë ndarë klubit per shenjëtari vetëm 150 euro kjo është e padrejtë.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-sa i perket turnirit "Rasim Kiqina" për mjetet që ju pyetet, mjetet janë kthye, por për hir të transparencës dhe opinionit që na përcjellin po ju njoftoj se pse nuk është mbajtur turniri, unë kam kërkuar që pagesa të bëhet nga ekipet përmes xhirollogarisë bankare e jo mjetet të mbahen neper xhepa kjo dikujt nuk i ka pëlqye dhe ka ardhë deri të mos mbajta e këtij turniri, e sa i përket subvencionimit të klubeve sportive ne i ndihmojmë edhe klubet tjera që kanë bërë kërkesë për këtë por ato që janë klube private ne nuk kemi obligim ndërsa klubet që i ka themeluar komuna ne kemi obligim edhe ti subvencionojmë, por ne këtë vit unë edhe me herët ju thashë se i kemi ndihmuar studentet me bursa.

BEQIR KIQINA-unë kisha kërkuar që turniri "Rasim Kiqina" në këtë vit të mbahet, të mos merret si arsytim ramazani, ramazani ndryshon në kohë është për nja 15 ditë ma herët nëse nuk gaboj, ka shumë te interesuar që pyesin se a do të mbahet ky turnir tradicional në këtë vit apo jo.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-i nderuari Kiqina dhe z.Bujupi unë që nga sot kërkoj që ju të dy të jeni pjesë e komisionit për mbajtjen e këtij turniri, por po ju njoftoj gjithçka ka për të shkuar sipas rregullave dhe përsëri nuk lejoj që mjetet të mbahen neper xhepa por të paguhen përmes bankës.

NEXHMEDIN BALA-unë kisha kërkuar që përgatitjet për turnirin "Rasim Kiqina" të bëhen me kohë po ashtu të fillojnë përgatitjet edhe për mbajtjen e ditëve të folklorit Drenasi 2018 që mbahet çdo katër vite.

LABINOT HALILAJ-hapi diskutimin për piken e pestë(5) të rendit të ditës;

5.Propozim vendimi për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës nr.463-34434 të dt.20.06.2016, në ngasjen kadastrave 726/15 në zonën kadastrave në Drenas, që ishin dhënë në shfrytëzim Kompanisë "Valdrini" SHPK.

Petrit Gashi -pasi kemi pika të veçanta, do të flas vetëm për pikën e rendit te ditës "Valdrini" SHPK, kam vërejtje sepse nuk kemi dokumente shtesë për këtë propozim vendim, nuk po flas më shumë për këtë propozim vendim sepse është fole shume dhe është thënë shumë, dhe mendoj se ky propozim vendim është i vonuar, edhe në të kaluarën ka pasur zëra qe ky operator nuk ka qene i kujdesshëm në përmbushjen e kontratës, ne si IQD do e mbështesim këtë propozim-vendim.

Petrit Sinani- unë do të diskutoj për të gjitha vendimet se cilën pike veç e veç, pasi qe edhe janë të natyrës se njëjte, e ndaje atë mendim se nëse komuna na paraqet vetëm një paragraf qe ka bazë ligjore ne do duhet t'i kthejmë këto prona komunale, unë shoh se këto propozim-vendime kanë materiale të mjaftueshëm qe neve nuk kemi nevojë të diskutojmë me gjerë e gjatë.

Beqir Kiqina- unë mendojnë se ajo pronë është dashur shumë me herët që të kthehet ne pronë komunale, unë jam i habitur se po shoh qe ka kaq shumë pika të rendit te ditës për shfuqizime te vendimeve, stacionin i autobusëve është në gjendje shumë të keqe, dhe është mirë që këtë pronë po e kthejmë.

Labinot Halilaj- kjo asamble mundet nesër me e jep një pronë një kompanie, dhe po e njëjta asamble mundet me e kthye po atë pronë në pronë komunale komfort ligjeve dhe rregulloreve ne fuqi, nëse operatori nuk përmbushe kushtet dhe objektivat komfort kontratës qe ka nënshkruar me komunën.

Vehbi Berisha- unë desha të flas për te gjitha pikat për një here, përpos që pikës 6 ku kërkuam që të hiqet nga pika e rendit te ditës sepse ka një vendim në gjykate, qysh në seancën e parë kryetar kemi kërkuar që të na vjen një raport për pronat, sinqerisht unë të përgëzoj për punën dhe përkushtimin për kthimin në pronë, ne se

cilën seancë po kemi një raport dhe një propozim vendim për kthimin e pronës komunale, ne si NISMA, jemi që këto tri prona të kthehen ne prone komunale, neve sinqerisht ju inkurajojmë që me këtë ritëm do ta kesh përkrahjen tone.

Labinot Halilaj- kaloi fjalën të Kryetari Lladrovci.

Kryetari, Ramiz Lladrovci- unë e pashe që asambleistat debatuan për të gjitha pikat 4 pikat e rendit të ditës, ndërsa Vehbia kërkoi që mos me u votua hiq, por unë kuptoj që me votu kundër, nëse me lejohet unë po dal në foltore dhe po jepi arsyetimet për të gjitha pikat edhe për atë pikë, nuk ka gjykatë që është duke ndjek dikon është padi private dhe është ne gjykatë civile, po jap sqarime, kërkoj falje për tonin, ne e kemi formuar komisionin dhe ju kam premtua se ne çdo seancë do të kemi nga një pronë ose dy prona ne këtë seancë ne kemi 4 prona për shfuqizim vendime dhe mos përmbushje të kontratave, ne kemi një raport prej 9 faqesh nga komisioni profesional të përbërë nga gjeodezia nga prona nga kadastra nga zyret ligjore.

Kryetari lexoi raportin e komisionit 9 faqesh para asamblistëve, që i njëjti të procedohet ne procesverbalin nga sekretaria e kuvendit.

Kryetari Ramiz Lladrovci-, vendimi i kuvendit te Drenasit me nr 35312312 i datës 04.03.2015, lidhur me lejin e këmbimit të pronës, për nevojën e zgjerimit të pronës.....

SHQIPE ZOGAJ- Unë pata dëshirë të flas po të gjitha u thanë nga Kryetari, akt vendimi ia ndalon komunës 3 pune juridike tjetërsimi, dhënja me qira dhe shfrytëzimi i ngastrës, mirëpo nuk ja ndalon komunës shfuqizimi i vendimit dhe kthimi i komunës, prandaj ne nuk bëjmë asnjë shkelje nëse këtë pronë ia kthej komunës.

Sabrie Kukaj- z.Kryetar ju lus që të mos bëni selektive te pronave, kurrë skam qenë pjesë e prapavijave politike dhe grupeve te ndryshme, unë e kam votua sepse ka qenë pronë për varreza dhe ka qenë në interes të qytetareve te këtij fshati.

Labinot Halilaj, z.Kukaj Kryetari është në punë voluminoze na duhet me besu shumë në punën e tij sidomos ne aspektin e kthimit te pronave komunale, çfarëdo prone që po sillet po e thuani që janë selektive, ne duhet të besojmë fort në punën e Kryetarit.

Sabrie Kukaj, është lënda në proces gjyqësor dhe neve nuk është dashtë me u marrë me këtë pronë dhe është interes kolektiv jo individual sikurse prona në Gllobar.

Kryetari Ramiz Lladrovci- a mundeni ju lutem nëse unë po bëjë selektiv te pronave a bënë të më tregoni të më jepni pronat me emër cilat janë unë e qoj komisionin edhe i vlerëson pa rregullsitë në ato prona, unë edhe uzopimet e Peshkopisë, që janë në stacion te autobusëve do t'i kthej.

Arigon Sinani, i nderuar kryetar me vjen mire për propozim vendimet te cilat i keni sjell ne seance për kthimin e pronave komunale ashtu siç keni premtuar në seancat e kaluara, mirëpo dua te ndalem tek pika per te cilën është në hetime.

Labinot Halilaj, hodhi në votimin pikat 5,6,7 dhe 8 të rendit të ditës për pikën e 5 të rendit të ditës në mënyrë unanime u votua për, tek pika e 6, 17-për,9-kundër 2- abstënime, pika e 7, në mënyrë unanime u votua për, tek pika e 8, në mënyrë unanime u votua për shfuqizimin e vendimit.

Labinot Halilaj hapi debatin për piken e 9 te rendit te ditës, propozim vendimin për bartjen e te hyrave vetanake.

Perparim Shala.

Labinot Halilaj, hapi për diskutim pikën e 10 te rendit te ditës, për formimin e komisionit për formimin e aksionareve në ndërmarrmjen PASTRIMI, pas propozimeve dhe votimit të fshehtë, komisioni ad-hok i formuar nga asamblea komentoi rezultatet dhe me vota u vendos që në këtë komision te jene Bujar Dervishi dhe Petrit Sinani.

Labinot Halilaj, hapi ne diskutim piken e 11 te rendit te ditës për diskutim, formimin e komisionit nga Kuvendi Komunal për zgjedhjen në fshatra dhe dhe vendbanimeve urbane.

Shqipe Zogaj, nga grupi parlamentar i PDK propozon Naim Xhelin për anëtarë të këtij komisioni.

Petrit Gashi, propozon për anëtare të këtij komisioni propozon Bedri Niken për anëtarë të këtij komisioni.

Edolina Plakiqi propozon Endrit Gllarevën për anëtarë të këtij Komisioni.

Labinot Halilaj, hodhi në votim pikën e rendit të ditës me këto tri propozimeve Naim Xheli, Bedri Nika dhe Endrit Gllareva, ne mënyrë unanime kalon.

Labinot Halilaj, hapi për diskutim piken e 12 Propozim Vendimin për emërimin e Biblotekes së Qytetit me emrin Ymer Elashani.

Shqipe Zogu, në emër të grupit parlamentar përkrahim këtë propozim-vendim për emërimin e kësaj biblioteke në emër të Ymer Elshanit.

Sabrie Kukaj, unë në fillim të kësaj seance thash se nuk jam kundër kësaj pike të ndryshme, mirëpo unë propozoj ne këtë seancë të behet edhe emërimi i shtëpisë së kultures Rifat Kukaj.

Labinot Halilaj, propozoi qe ky propozim-vendim të kaloj të pikat e ndryshme, dhe kaloj fjalën tek asambleisti i PDK Adebm Bucolli.

Adem Bucolli, edhe unë kam një propozim-vendim për emërimin e palestrës së sporteve me emrin e dëshmorit të kombit dhe hendbollistit Hysni Jetullahu, mirëpo këtë propozim-vendim e kalojmë tek pikat e ndryshme.

Petrit Sinani, i përgëzoi koleget për gadishmerin dhe lavdat për këto propozim vendime dhe i mbështes si te tilla ashtu edhe si u dakorduam.

Labinot Halilaj, hodhi në votim piken e 12 te rendit te ditës, propozim vendimin për emërimin e bibliotekës se qytetit me emrin Ymer Elshani, në mënyrë unanime Kuvendi i Komunës vendosi qe biblioteka e qytetit të mbaj emrin Ymer Elshani.

Labinot Halilaj, hapi për diskutim piken e 13 të rendit të ditës, Zëvendësimin e anëtarit te komitetit për politikë dhe financa si dhe zëvendësimin e anëtarit për komitetin për komitete, gjithashtu Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z.Halilaj para asamble-së prezantoi dorëheqjet nga anëtarët e me hershëm, dhe komfort ligjit për vetëqeverisje lokale dhe udhëzimeve administrativ ne fuqi për zgjedhjen e anëtareve të komoniteveve në Kuvendin Komunal, Kryesuesi kërkoi nga Vizioni për Drenas që të propozoi anëtarin për këtë komitet.

Endrit Gllareva nga Vizioni për Drenasin propozoi Fitore Morinen për KPF, ndërsa Burim Bujupi nga Nisma për Kosovën propozon zëvendësimin Nexhmedin Bala për komunitetin për Komonitete.

Labinot Halilaj, hodhi ne vendim pikën e 13 të rendit të ditës me këto propozime për zëvendësim dhe Kuvendi i Komunës në mënyrë unanime vendosi për këto propozime, nga Zhavit Drenori me Fitore Morinen n KPF dhe Vehbi Berishen me Nexhmedin Bala në komitetin për komonitete.

Labinot Halilaj, hapi për diskutim piken e 14 te rendit të ditës, propozim vendimin për plotësim ndryshimin e statutit të komunës.

Beqir Kiqina, unë kam qenë pjesë e komisionit për hartimin e këtij propozim vendimi se bashku me anëtarët e tjerë nga kuvendi dhe nga ekzekutivi, dhe pas këtij hartimi të këtij propozim vendimi kërkoj qe edhe nga grupet tjera te miratohet ky ndryshim plotësim i këtij statuti dhe shtimin e dy drejtorive shtesë, pasi qe kemi raste qe ne komuna edhe me te vogla se ne në komuna ku ka edhe me pak numër te banoreve e kalojnë shifren e drejtorive te komunës tone.

Petrit Gashi, edhe unë e përkrahi këtë propozim ndryshim për ndryshimin dhe

plotësimin e statutit të komunës, dhe si qytet kemi nevojë për me shumë zhvillim ekonomik dhe bujqësia, prandaj duke konsideruar se kemi shterrur debatin për këtë temë, kërkoj nga ju që të hedhet në vendim.

Labinot Halilaj, duke i falënderuar dy parafolëset për kontributin në debat, hodhi në votim pikën e 14 të rendit të ditës, me 25 vota për dhe 1 abstenim miratohet propozim vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të Komunës së Drenasit.

Labinot Halilaj, hapi për diskutim pikën e 15 të rendit të ditës të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit para asamblistëve paraqiti rekomandimet e MAPL, për ndryshimet në rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoba të cilat janë teknike dhe në mënyrë formale hodhi në votim këto ndryshime teknike, Kuvendi i Komunës në mënyrë unanime vendosi për këto ndryshime.

Labinot Halilaj, tek pika e ndryshme kaloi fjalët tek Sabdrie Kukaj, e cila propozoi që salla e kulturës të emërohet me emrin Rifat Kukaj.

Shqipe Zogu, nga grupi kuvendar i PDK e cila shfaqti vullnetin e këtij grupi kuvendar për ke propozim-vendim.

Labinot Halilaj hodhi në vendim këtë propozim vendim që me emrin e Rifat Kukaj të emrohet salla e kulturës, në mënyrë unanime u votua ky propozim-vendim.

Labinot Halilaj tek pika 14 të ndryshme, kaloi fjalën tek asambleisti i PDK, Adem Bucolli.

Adem Bucolli, unë me herët dhashë një propozim-vendim për emërtimin e Palestres së Sporteve Hysni Jetullahu, mirëpo tash dua ta jap edhe një arsyetim për këtë propozim -vendim, për ish hendbollistit të KH Drenica dhe të ftuarit për reprezentacionit të asaj kohe, mirëpo Hysniu ishte mbi të gjitha një sportdashës dhe një atdhetari i pa heshtur i qeshtjes kombtare, andaj për mu dhe për ju do të ishte nder që kjo palestër do ta mbante emrin e shokut tim të luftës Hysni Jetullahu, andaj kërkoj nga ju të nderuar koleg që të përkraheni këtë propozim vendim.

Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë propozim vendim dhe antaret e kuvendit komunal, në mënyrë unanime vendosi për emërtimin e palestrës së sporteve të emërtohet me emrin e hendbollistit dhe deshmorit Hysni Jetullahu.

Labinot Halilaj kaloi fjalën tek antari i kuvendit komunal z. Perparim Shala, i cili kerkoi që të diskutohet rreth kërkesës së t'i për shtyllat e KEDS në fshatin Sankovc sepse situata është në rrezik dhe kerkoi nga drejtorja e shërbimeve publike, Kryesuesi kaloi fjalën tek drejtoresha, z.Lumnje Krapit.


Lumnje Krapit- drejtoreshë për shërbime publike, faleminderit i nderuar Kryesuesi i nderuar Kryetar në pasi kemi marrë këtë kërkesë nga z.Shala kemi dalur në teren menjëherë, mirëpo atë rrjetë në atë vend e ka përsipër për mirëmbajtje rajoni i Ferizajit, dhe e kemi pak sa problem të intervenojmë direkt mirpo neve jemi në kontakt dhe shumë shpejtë do të rregullohet ajo qeshje.

LABINOT HALILAJ- mbylli këtë seancë rreth orës:17 e 30 minuta

Proces mbajtësit:

Xhavit Nebihi

Besart Morina



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:

Labinot Halilaj

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Të nderuar kolegë, anëtarë të Kuvendit Komunal,

Shumë të respektuar qytetarë të Komunës së Drenasit,

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale e përkufizon statusin ligjor të komunave duke e përcaktuar Kuvendin Komunal si organin më të lartë të Komunës që përbëhet prej antarëve të tij të zgjedhur.

Pa dyshim se të qenit anëtar i organit më të lartë të komunës së Drenasit nga viti 2013 për mua përbën një nder dhe privilegj, por para së gjithash edhe përgjegjësi para qytetarëve të komunës sonë e posaçërisht para votuesve të mi.

Votën e tyre e konsiderova gjithmonë si "kontratë" për të shërbyer në emër të tyre për interesat e përgjithshme dhe të gjithmbarshme të të gjithë qytetarëve të Komunës sonë në Kuvendin e Komunës.

Gjatë kësaj periudhe të gjatë të punës në Kuvendin Komunal, unë si antar jam përpjekë me përkushtim të madh që të jem vazhdimisht aktiv e i angazhuar në ushtrimin e të gjitha funksioneve dhe kompetencave të anëtarit të Kuvendit, duke ndikuar në ecurinë e mbarë të punëve të qeverisjes komunale.

Prioritet kisha para se gjithash që qytetarin t'a ofroj sa më afër vendimmarrjes komunale. Këtë provova ta bëj qoftë me publikime të vazhdueshme të informatave të rëndësishme komunale në llogaritë e mia në rrjete sociale dhe media, në takime të përhershme me qytetarë, të cilat për periudhën 2013 deri më sot ishin mbi 250 të tilla në gjithë territorin e Komunës sonë si dhe me raportin vjetor që ua dërgova bashkfshatarëve të fshatit tim shtëpi për shtëpi në çdo fundvit.

Përmes formimit të Komisionit për monitorimin e projekteve në terren në vitin 2015, Komision ky mbipartiak dhe gjinor, i përbërë nga anëtarë të Kuvendit Komunal, takuam dhe me marrëveshje paraprake me të gjithë kryetarët e fshatrave u koordinuam që të monitorojmë punët gjatë zhvillimit të projekteve infrastrukturore në terren dhe më pas rreth punës se këtij Komisioni patëm raportuar në Kuvendin e Komunës, përfshirë edhe rekomandimet e nevojshme.

Në kuader të studimeve të mia post-diplomike, qeverisjes lokale në Drenas, respektivisht punës së Kuvendit të Komunës, gjatë vitit 2015 i pata bërë edhe një studim shkencor të cilin e pata publikuar në rrjetet sociale, e që rekomandimet e tij fatkeqësisht kurrë nuk u morën seriozisht, qoftë nga Kryetari i kaluar apo i tashmi.

Përkundër faktit se që nga ardhja e Kryetarit Lladrovci në pushtet është shtypur dhe stërkequr zëri opozitar në Kuvendin e Komunës, unë vazhdimisht i kam qëndruar besnik betimit të anëtarit të Kuvendit dhe detyrave të tij, duke kontribuar në mbledhjet e Kuvendit, në monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes në terren dhe zbatimit të vendimeve të Kuvendit Komunal. Përkundër dallimeve në pikëpamje politike me kryetarin dhe partinë që ka shumicën në Kuvendin Komunal, gjithnjë kam qenë dorë e shtrirë për bashkëpunim në çështje të interesit të përgjithshëm dhe poashtu kritik i paepur në çështjet që kanë të bëjnë me interesa personale, nepotiste dhe korruptive, çasje kjo që mendoj se do të duhej të aplikohet nga të gjithë!

Mirëpo, gjatë punës dhe rrugëtimit tim politik janë ndërlidhur edhe rrethana e pengesa që e kanë pamundësuar efikasitetin tim më të madh në dobi të votuesve që ma kanë dhënë votëbesimin dhe gjithë qytetarëve të Komunës sonë, e këto pengesa apo defekte janë shfaqur sidomos me ardhjen në pushtet të kryetarit të ri, e të cilat janë:

1. Degradimi i funksionit të Kuvendit Komunal nga ana e Kryetarit, sidomos shkelja e vazhdueshme e Rregullores së Punës së Kuvendit Komunal duke ndërprerë arbitrarisht fjalën e anëtarëve të Kuvendit.
2. Moslejimi i hedhjes në votim të propozimeve të antarëve të Kuvendit Komunal për propozim-vendime, gjë që ka bërë që të shkellet e drejta themelore e tyre për të dhënë kontributin e tyre mbështetur në kompetencat e përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.
3. Ndërhyrja e vazhdueshme në punën e Kryesuesit të Kuvendit Komunal, gjë që ka rezultuar me ndikim dhe diktat të drejtpërdrejtë në mbarëvajtjen e punës së Kuvendit Komunal, duke shkelur kështu në mënyrë flagrante Rregulloren e punës së Kuvendit Komunal.
4. Mosaplikimi i votimit elektronik (me kartela) sado që kjo është teknikisht e mundshme, duke ndikuar me këtë veprim në mostransparencë dhe llogaridhënie të secilit antarë të Kuvendit Komunal për votën e tyre PËR, KUNDËR APO ABSTENIM lidhur me vendimet e marra në Kuvend. Kjo përben madje shkelje elementare të të drejtave tona, sepse asnjëri nga ne kështu nuk mund ta verifikojmë në çdo kohë votën tonë për vendime të caktuara.

5. Moslejimi i formimit të Komisioneve monitoruese me antarë të Kuvendit Komunal për dikastere të caktuara psh.: vlen të përmenden dy komisionet e kërkuara vitin e kaluar, ai për arsim dhe urbanizëm dhe këtë vit Komisioni për pronën komunale, duke ua pamundësuar kështu antarëve të Kuvendit çasjen direkte në gjendjen faktike në këta sektorë, dhe

6. Moszgjatja e kontratës për mediumin lokal, duke ndikuar që punimet e Kuvendit Komunal të mbesin në terr informativ e mediatik për qytetarët dhe me këtë transparenca, llogaridhënia dhe komunikimi me votuesit (qytetarët) ka marrë goditje të rëndë.

Përkundër mungesës së vullnetit të mirë dhe konstruktiv për tejkalimin e këtyre defekteve dhe pengesave të qëllimta për dekurajimin e zërit të anëtarëve të Kuvendit Komunal, e sidomos atij opozitar, megjithatë, edhe në këto rrethana kemi arritur sado-kudo që të instalojmë një mentalitet dhe frymë të guximit qytetar dhe opozitarizmit kritik, frymë kjo e cila nuk mund të ndalet apo ndrydhet me kurrfarë autoritarizmi apo kërcënimi nga pozita e pushtetit superior.

Konsideroj që edhe në këto rrethana kam përmbush një pjesë të vështirë të misionit dhe parimeve të mia politike, prandaj sot para jush jap **dorëheqje të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit Komunal** nga radhët e Vizionit për Drenasin dhe vendin tim e zë anëtar i radhitur me më së shumti vota z. Gentrit Gërguri, duke sjellë frymën e rinisë progresiste dhe proaktive në këtë Kuvend nga radhët e Vizionit për Drenasin.

Kërkoj ndjesë nga votuesit e mi besnik, por fuqia e votës së tyre nuk më ka dhënë fuqi më të madhe politike që të përmbush në tërësi projektin dhe programin tim politik në dobi të qytetarëve të Drenasit, prandaj ato synime do t'i përmbush me aktivitetin tim politik e shoqëror në forma dhe aspekte tjera të angazhimit, gjithnjë në të mirë të qytetarit e për reforma të qeverisjes lokale, kundër krimit, korrupsionit, nepotizmit e dukurive të shëmtuara shoqërore, që na kanë lënë kaq mbrapa dhe pothuajse na e kanë humb perspektiven për të ardhmën e ndritur të këtij vendi. Ky do të jetë kapitull i ri në jetën dhe angazhimin tim shoqëror, për çka do të jeni me kohë të informuar!

E di që kjo dorëheqje nuk zgjidh gjërat që s'kanë shkuar si duhet, por është kurajo dhe moral politik imi, që dëshmon përgjegjësi dhe vetëdijësim e jo dobësi dhe dorëzim, prandaj më bën të ndihem mirë. Mbyllja e këtij kapitulli të rëndësishëm në jetën time, hapë një kapitull tjetër poaq premtues dhe pozitiv.

Për rrugëtimin tim politik nuk mund të mos përmend dhe falënderoj të gjithë bashkpunëtorët, sidomos Afrim Berishen dhe Xhevdet Shehun, njëri u rrah dhe tjetrit ju

organzua pritë për atentat, dhe të gjithë bashkëpunëtorët e mi tek Vizioni për Drenasin për besimin, dedikimin dhe përkushtimin në rrugën aspak të lehtë politike si subjekt i ri ! Gjithmonë do të jem pranë jush në çfarëdo forme të mundshme!

Posaçërisht Ju falenderoj juve kolegë, anëtarë të Kuvendit Komunal, që shumëherë kemi polemizuar e debatuar, mirëpo kurrë si armiq, vetëm si kundërshtar politik në ballafaqim ideshë e mendimesh për të mirën e qytetarit. Jo pse janë parime e angazhime të miat jetësore, por ideja e barazisë qytetare, prosperitetit ekonomik e shtetit ligjor herët a vonë, me apo pa Xhavitin, do të triumfojë dhe do të jetë baza e perspektivës së shtetit tonë të ri !

Juve ju uroj shumë suksese dhe ju falenderoj për vëmendjen e Juaj!

Xhavit Drenori

Drenas, më 29.03.2018



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
KUVENDI I KOMUNES



12 Nr. 060-35127 dt. 20.06.2018

Mbledhja e rregullt e Kuvendi Komunal 04.05.2018

PROCESVERBAL

**I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më
dt.04.05.2018**

Mbledhjen e kryesoi LABINOT HALILAJ – Kryesues

**Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të rregullt të Kuvendit
Komunal ku të pranishëm ishin 30 anëtarë**

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

- 1.Procesverbali i mbledhjes të dt.29.03.2018
- 2.Propozim vendimi për subvencionimin e KF"Feronikeli"
- 3.Propozim vendim për subvencionimin e Këshillit për veprim rinor lokal "KVRL"
- 4.Propozim vendim për rrenimin e ishujve në sheshin "Fehmi Lladrovci"
- 5.Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit të Komunës nr.421-3587 të dt.19.06.2009 që i është dhënë prona komunale në shfrytëzim NTP "Floriani" më pronar Muhamet Ajazi nga Komorani.
- 6.Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit të Komunës nr.421-3587 të dt.19.06.2009 që i ishte dhënë prona komunale në shfytëzim NTSH "BEINDENERINGBAU" me pronar Gëzim Gegaj nga Komorani
7. Propozim vendim për kthimin e pronës komunale, të dhënë në shfrytëzim të përhershëm pronarit Hajdar Heta nga Gllogoci.
- 8.Propozim vendimi për kthimin e pronës komunale të dhënë në shfrytëzim të përhershëm pronarit Zejnullah Strumcaku nga fshati Abri e Eperme
- 9.Propozim vendim për ndarjen e pronës komunale për varrezat e fshatit Korroticë e Ultë
- 10.Propozim vendim për formimin e komisionit për rregulloren për dekorata dhe mirënjohje.

11. Propozim vendimi për formimin e komisionit për ndryshimin e stemës dhe vulës së komunës
12. Propozim vendimi për financimin e projektit të "HANDIKOS-it"
13. Raporti financiar Janar-Mars 2018.

Prezentuan: Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të OSCE-së si dhe qytetar.

LABINOT HALILAJ-Hapi diskutimin për këtë mbledhje, i cili i njoftoj më rendin e ditës dhe kërkoj nga të pranishmit se a kanë ndonjë propozim për këtë rend dite apo pajtohen më këtë rend dite.

SHQIPE ZOGU-Propozoj që pikës së 11 të rendit të ditës t'i shtohet edhe fjalia që statuti i Komunës së Drenasit të harmonizohet me ligjet në fuqi.

BURIM BUJUPI-Unë kam një shqetësim por edhe vërejtje pse nuk po merren për bazë rekomandimet që kemi marrë në komitet për politikë dhe financa, ne si komitet për politikë dhe financa kemi qenë kundër disa vendimeve që i kemi pasur dhe i kemi sot në rendin e ditës, unë po kërkoj që nga rendi i ditës të hiqen pika 2,9 dhe 11 e thashë edhe më heret se në komitet nuk janë votu këto pika të rendit të ditës, në të kundërtën ne për këtë çështje do t'i drejtohem MAPL-së.

PETRIT GASHI-Është mirë të hiqen praktikët e këqija, vendimet që merr komiteti për politikë dhe financa duhet të mirren për bazë, në rast se nuk merren për bazë rekomandimet e komitetit për politikë dhe financa pse atëherë me ekzistim ky komitet, ligji e parasheh që propozimet fillimisht të shkojnë për diskutime në komitet për politikë dhe financa pastaj të shkojnë për kuvend, edhe unë kërkoj që pika 2,9 dhe 11 të hiqen nga rendi i ditës ashtu siç ka rekomanduar komiteti për politikë dhe financa.

BEQIR KIQINA-Sa i përket rendit të ditës unë kërkoj që pika 11 e rendit të ditës të hiqet, edhe në komitet për politikë dhe financa ne si aleancë kemi qenë kundër kesaj pike që bëhet fjalë për komisionin për ndryshim të të stemës dhe vulës së komunës së Drenasit, nuk kemi nevojë me ndryshim, askush asnjë kërkesë nuk e ka bërë që të bëhet ndryshimi i tyre as prej qytetarëve e as prej MAPL-së, prandaj ne si AAK jemi kundër këtij propozimi.

FLORENTINA ELEZI-Kërkoj që nga rendi i ditës të hiqen tri pika të rendit të ditës pika 2,9 dhe 11, edhe në komitet për politikë dhe financa këto pika nuk janë votu prandaj kërkoj të hiqen nga rendi i ditës ne nuk do t'i votojmë këto tri pika të rendit të ditës.

Para se të hedhet në votim rendi i ditës nga ana e Kryesuesit 9 anëtarë nga opozita e lëshuan sallën për të mos e votuar këtë rend dite me pikat që kërkuan të hiqen pra ishte fjala për pikën 2,9 dhe 11.

LABINOT HALILAJ-Hodhi në votim rëndin e ditës: me rastin e votimit prezent ishin 19-anëtar, për: 17, kunder: 01, abstenim: 01.

NEXHMEDIN BALAJ-Pati pyetje se a është kthyer vendimi nga MAPL-ja për varrezat në Korroticë apo jo ne kemi informatë se MAPL-ja e kthyer në rishqyrtim këtë vendim.

KRYETARI I KOMUNËS Z. RAMIZ LLADROVCI -MAPL-ja është keqkuptuar rreth këtij vendimi ne jemi në konsultime me ta dhe për momentin është pezull dhe janë duke u marrë më këtë vendim në momentin kur ata na kthejnë përgjigje ne ju informojmë.

LABINOT HALILAJ-Para se të fillojmë me diskutime për pikat e rendit të ditës ju njoftoj se për pikën e parë të rendit të ditës nuk e kemi materialin që është fjala për proces verbalin e mbledhjes se kaluar pasi që nuk ka pasur mundësi procesmbajtësi

më e perfundu për shkak të problemeve shëndetsore që ka pas prandaj unë hapi diskutimin për pikën e dytë të rëndit të ditës

2. Propozim vendimi për subvencionimin e KF"Feronikeli"

SHQIPE ZOGU-Grupi parlamentar i PDK-së e përkrah këtë propozim-vendim dhe ne unanimisht e mbeshtesim dhe kërkojmë që ky propozim të votohet nga kuvendi.

VEHBI BERISHA-Ne gjithherë e kemi subvencionu KF"Feronikeli" por nderhyrja e Kryetarit në këtë klub na shtynë që ne të mos e përkrahim këtë subvencionim, rezultatet e dobëta në këtë vit dihen shkaqet, prandaj ne jemi kunder këtij propozim-vendimi.

FITORE MORINA-Kërkoj që ky propozim të shtyhet për mbledhjen e radhës edhe ne jemi kundër këtij propozim-vendimi.

SOKOL BYLYKBASHI-Ne gjithmonë e kemi përkrahë sportin dhe e përkrahim, por problemi është se si me votu ne një propozim-vendim për subvencionim kur ne si kuvend nuk kemi asnjë raport të klubit të Feronikelit se ku janë shpenzuar dhe si janë shpenzuar mjetet për vitin e kaluar mjetet që i ka ndarë kuvendi për këtë klub, le të na vijë një raport e pastaj i shpenzimeve e pastaj mund të votojmë për propozime tjera unë sot jam kunder këtij propozim-vendimi.

BEQIR KIQINA-Ne AAK-ja jemi për këtë propozim-vendim për subvencionimin e klubit të Feronikelit, por jemi kundër se si është ndarë bugjeti për klubet tjera, nuk po përkrahen si duhet.

PETRIT GASHI-Pa arsye bëhet selektimi i klubeve sa i përket subvencionimit, kjo nuk është e drejtë, klubet ndihmohen në bazë të rezultateve e jo sipas dostave që kemi apo pazarev që bëhen, rast konkret po përmendi feronikelin që ndërhyrjet në këtë klub paskan qenë për pazare e jo për suksese, rezultatet e dobta tregojnë vetë, prandaj ne jemi kundër këtij propozim vendimi.

PETRIT SINANI-Sa i përket rezultateve të dobëta që po tregon feronikeli edhe unë jam i shqetsuar, por klubet sportive pavarësisht rezultateve duhet të përkrahen, unë jam për këtë propozim-vendim por kërkoj që herave tjera të na sillet një projekt se qka në të vërtetë i duhet një klubi, se këto mjete për një klub si feronikeli janë pak, klubi futbollistik feronikeli ka qenë, është dhe do të jetë krenaria e qytetit të Drenasit, por kërkoj që të bëhet praktik që fillimisht të na vijë një raport për shpenzimet që janë bërë e pastaj të votojmë për mjete tjera unë sot jam për këtë propozim-vendim.

ADEM BUCOLLI-Unë jam vetë spozorues por edhe në kryesin e klubit të feronikelit, shpenzimet mujore në këtë klub janë shumë të mëdha, e kalojnë 40,000 Euro në muaj, unë propozoi që subvencionet për këtë klub të rriten e jo të zvoglohen siq po kërkojnë disa anëtarë ketu, unë jam me u rritë bugjeti këtë klub.

PETRIT GASHI-Nuk është mirë të bëhet selksionim i klubeve sa i përket subvencionimit, është jo e drejtë që 60% e subvencioneve të shkojnë vetëm për klubin e Feronikelit ndersa 40% e këtyre mjeteve për të gjitha klubet tjera kjo nuk është mirë.

SABRIJE KUKAJ-Ne si kuvend jemi fajtor se kur e kemi aprovuar bugjetin kemi ndarë shumë pak mjete për subvencione, por nuk na është lejuar, por në këtë rast nuk është vetëm Feronikeli në superligë është edhe klubi i hendbollit që është në superligë dhe duhet të përkrahet unë kisha kërkuar që 5.000 euro të hiqen nga klubi i feronikelit dhe këto mjete të ndahen për klubet tjera.

BURIM BUJUPI-Unë edhe më heret e kundërshtova këtë propozim-vendim, kundër kemi qenë edhe në komitetin për politikë dhe financa, si është e mundur që mbi 60% e subvencioneve të ndahen vetëm për klubin e feronikelit ndërsa të gjitha klubet tjera

40%, këtu po shihet se po anashkalohen klubet tjera me nga 150 euro qfarë ndihme është kjo.

NEXHMEDIN BALAJ-Ne para 4 viteve jemi krenuar me klubin e futbollit feronikeli, fakt që më herët është subvencionu me 100 mijë euro por edhe subvencinet kanë qenë mbi 200 mijë euro të ndara për sport, por sot këto mjete prej 30 mijë euro nuk i mbulojnë shpenzimet as 5% të shpenzimeve të klubit, po ku po mbesin klubet tjera, ne kemi ndarë shumë pak mjete për klube të sportit, sporti duhet të përkrahet e sidomos klubet siç janë feronikeli dhe klubi i henbollit e kipe që janë ne super lig dhe kanë shpenzime të medha.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-Unë i vlersoj çdo vërejtje dhe sygjërim tuaj, i pranoj edhe kritikën, por sa i përket se kemi ndarë pak mjete për subvencione unë ju them se në këtë vit subvencionet janë rritur dhe në këto subvencione i kemi ndarë për fëmijët tuaj pra i kemi ndarë për student mbi 107 bursa i kanë marrë, edhe unë mendoj hala me rritë numrin për ndihmë studentëve planifikoj që ky numer të shkoj deri në 200, ne jemi me i përkrahë edhe klubet tjera por aq sa ka buxhet, jashtë kufijve nuk mund të dalim, tash në klubin e feronikelit ka rregull, të gjitha pagesat bëhen përmes xhirollogarisë, ne e respektojmë ligjin nuk është e vërtetë se bejmë selektim të klubeve.

SOKOL BYLYKBASHI-Mua më interson se a ka raport të shpenzimeve nga ana e feronikelit apo jo deri me tash kur ne po diskutojmë për këtë çështje

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-jo ende nuk kemi pranuar asnjë raport
LABINOT HALILAJ-Hodhi në votim rëndin e ditës: me rastin e votimit prezent ishin 25-anëtar, për:16, kunder :08, abstenim :01

LABINOT HALILAJ-Hapi diskutimin për pikën e tretë të rëndit të ditës

3. Propozim vendim për subvencionimin e Këshillit për veprim rinor lokal "KVRL"

SHQIPE ZOGU-Mund të themi se është e vetmja organizatë që merret me aktivitete dhe nuk ndalen, dhe gjithëherë kanë raportu në kohë, ne si grup parlamentar i PDK-së e përkrahim këtë propozim-vendim.

VEHBI BERISHA-Edhe ne e përkrahim këtë propozim-vendim për financimin e KVRL-së dhe kërkoj që të votohet ky propozim-vendim.

ENDRIT GLLAREVA-Ne jemi për me përkrahë këtë propozim-vendim, por kam vërejtje që kur është fjala të shpenzimet të mos ndodhë sikurse vitin që shkoj që mjetet të mos keqpërdoren dhe të na vijë një raport i shpenzimeve nga KVRL-ja.

BEQIR KIQINA-Edhe ne si AAK jemi për këtë propozim-vendim veprimet dhe vendimet e drejta i përkrahim, por nuk duhet paragjykuar se a i përkrahim ne apo jo vendimet, ne i përkrahim vendimet që merrë dega e AAK-së në Drenas ne perfaqësojmë degën tonë këtu, por në këtë rast unë kisha kërkuar që KVRL-ja të përkrahet edhe me subvencionim të ndonjë kompjuteri, si dhe për zyre të kenë kushte më të mira se rinia jonë e meriton një gjë të tillë, unë kërkoj që të përkrahet ky propozim-vendim për subvencionimin e KVRL-së.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-Unë do të japë kompjuterët KVRL-së, me siguri ju vetëm e paskeni marrë vesh dikur, por edhe zyret i kanë të mira, kushtet do të ju plotësojmë të gjitha që kërkohen nga KVRL-ja.

SABRIJE KUKAJ-Objekti i cili është i ndertuar të shkolla "Rasim Kiqina" është ndertuar për aktivitete të rinisë dhe OJQ-ve, komuna duhet ta marrë në menagjim dhe këtë objekt ta shfytëzoj, por edhe KVRL-ja duhet të jetë e zotë që të kërkojnë përkrahje nga donatorët e jo të presin gjithëherë nga komuna që t'i ndihmoj.

PETRIT GASHI-Ne duhet t'i përkrahim edhe rininë por edhe gratë në projektet e tyre, por ne kërkojmë që të kenë një planprogram për hartimin e projekteve dhe të na prezantojnë në kuvend atë projekt, ne e mbështesim këtë propozim vendim por mirë është që kur të vijë propozimi të kemi bashkangjitur edhe planin.

PETRIT SINANI-Edhe ne e përkrahim këtë propozim vendim, por për çdo aktivitet që zhvillon KVRL-ja duhet të kemi një raport financiar se si janë shpenzuar mjetet dhe duhet të kenë bashkëpunim KVRL-ja me u interesu më tepër, dhe kërkoj që ky propozim të hidhet në votim.

LABINOT HALILAJ-Hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës:

Më rastin e votimit prezent ishin: 28 anëtarë: për:28, kundër:0 dhe abstenim:0

LABINOT HALILAJ-Hapi diskutimin për pikën e katert të rendit të ditës:

4.Propozim-vendimi për rrenimin e ishujve në sheshin "Fehmi Lladrovci"

SHQIPE ZOGU-Grupi parlamentar i PDK-së e përkrahë këtë propozim-vendim për rrenimin e ishujve në sheshin "Fehmi Lladrovci", pasi që në këtë shesh pritet të vendoset shtatorja e Fehmi dhe Xhevë Lladrovci.

VEHBI BERISHA-Ne jemi për këtë propozim-vendim por pse këtij propozim vendimi nuk ju ka bashkangjitur një arsyetim, për çdo vit ndryshime në atë shesh, edhe para disa viteve është rrenuar edhe një amfiteater që e quanin, mirë ka qenë që ky propozim-vendim të ketë edhe arsyetimin.

PETRIT GASHI-Unë nuk jam kundër këtij vendimi por ky vendim nuk ka arsyetim, për rrenimin e këtyre ishujve duhen shpenzime, çdo vit komuna po shpenzon për këtë shesh, pa një plan nuk e di se si të veprohet, mirë ka qenë që ne ta kemi një plan para vetës ta dimë se si do të veprohet.

SHQIPE ZOGU-Sa i përket këtij propozim-vendimi neni 3 e specifikon shumë mirë se rrenimi i këtyre ishujve nuk paraqet implikime bugetore dhe kërkoj që ky propozim-vendim të votohet.

PETRIT GASHI-Unë kërkoja që të kemi një plan vizuel për sheshin të dimë të gjithë se si do të duket sheshi.

PETRIT SINANI-Mirë ka qenë që të kemi një plan konkret për këtë shesh, ta dimë se çka ka me u punu aty, unë jam për këtë propozim-vendim por këtij propozimi ka qenë mirë t'i bashkangjiten edhe dokumente tjera përcjellëse e jo në këtë formë pa kurrëfarë arsyeimi.

BEQIR KIQINA-është dashtë të kemi një plan vizuel për sheshin ne jemi pro këtij propozim-vendimi, kjo punë është dashtë të kryehet edhe më heret.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI- I njoftoj për vendin se ku do të vendoset shtatorja, dhe sa i përket rrenimit të këtyre ishujve në sheshin "Fehmi Lladrovci" parashihet që në ato vende ku do të bëhet rrenimi i këtyre ishujve ne do të bëjmë gjelbërim, komuna nuk do të shpenzojë asnjë cent sa i përket kësaj çështje kjo do të realizohet përmes donatorëve që kanë shprehë dëshirën për të përkrahur këtë projekt.

PETRIT GASHI-Edhe unë jam për, por ne vetëm duhet të jemi të njoftuar zyrtarisht se si do të duket sheshi.

HAKA TAHIRAJ-Unë kërkoj që ata drunjë që do të hiqen në shesh të vendosen para çerdhes se femijve se është shumë e nevojshme që aty të ketë disa drunjë.

LABINOT HALILAJ-Hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës:

Më rastin e votimit prezent ishin: 28 anëtarë, rezultati i votimit ishte si vijon: Për28, kunder:0 dhe abstenim :0.

LABINOT HALILAJ-Hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Propozim-vendimi për shfuqizimin e vendimit për të komunës nr.421-3587 të dt.19.06.2009, që i ishte dhënë prona komunale në shfytëzim NTP"FLORIANI" me pronar Muhamet Ajazi nga Komorani

PERPARIM SHALA-Unë i përkrahu këto propozim-vendime dhe kthimin e pronave komunës për të gjithë ata që nuk i kanë plotësuar kriteret por në këtë rast kur bëhet fjalë për këtë pronarin në komoran Muhamet Ajazin kanë kaluar shtatë apo tetë vite dhe komuna nuk ka ndermarrë asgjë tu jepet edhe një afat shtesë nuk u ka mbetur shumë dhe t'ju mundësojmë këtyre bizneseve të kryejnë punet e tyre

PETRIT SINANI-Unë jam pro këtyre propozim-vendimeve dhe kthimin e pronës komunës, për vendin që po flasim nuk ka të ndertuar asgjë përveç do shtyllave, nuk ka arritë që t'i përmbahet kontratës nuk i kanë përfill kriteret, komuna në këtë rast është e obliguar që këto prona t'i kthej në pronësi të komunës dhe unë i përkrahu këto propozim-vendime.

EDOLINA PLAKIQI-Edhe ne AAK-ja jemi për kthimin e pronave që nuk i kanë përfill kriteret e kontratës, por në këtë rast kërkoj që këtij pronari t'i mundësohet vazhdimi i kontratës se paku edhe tre muaj pasi vetë ka deklaruar se ka pas problem familjare për të realizuar projektin sipas kontratës.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-të ndëruar ne nuk mund t'i vazhdojmë kontratën në këtë rast Muhamet Ajazit, plot 9 vite po bëhen dhe nuk e ka realizuar projektin e po ta realizon për tre muaj kjo është e pamundur, dhe përveç kësaj ky ka edhe uzurpim një pjesë prandaj nuk ka mundësi t'i vazhdohet, për këtë unë kam biseduar edhe me Muhametin dhe e kam njoftuar.

ARTA GJYLANI-Unë kisha propozu ma i dhanë një afat shtesë prej tre apo gjashtë muajve nese ai nuk e realizon atë ka në kontratë atëherë ne si kuvend marrim vendim për kthimin e kësaj prone.

ADEM BUCOLLI-Nese ne në këtë rasti i vazhdojmë kontratën ne vetëm po e demtojmë komunën unë jam për këtë propozim-vendim dhe kërkoj që prona t'i kthehet komunës

LABINOT HALILAJ-hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës;

Më rastin e votimit prezent ishin: 27anëtarë, rezultati i votimit ishte si vijon: Për;19, kundër05, abstenim 03.

LABINOT HALILAJ-Hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit të komunës nr.421-3587 të dt.19.06.2009 që i ishte dhënë prona komunale në shfytëzim NTPSH"BEINDENERINGBAU" me pronar Gëzim Gegaj nga Komorani

BEQIR KIQINA-Sa i përket këtij propozim-vendimi për shfuqizim unë kam biseduar më këtë pronar ai ju ka përmbajtur kushteve të kontratës fusha ishte e ndertume, obligimet ndaj komunës i ka kry, ka punu diqka nuk është që nuk ka punu, i ka pas disa probleme familjare që nuk ka mundur në tersi me ju përmbajtë kontratës por ka shprehë gadishmerin dhe ai ka kerkuar të shtyhet edhe për një periudhë ky propozim-vendim se vetëm ka filluar edhe punimet dhe është në perfundim të realizimit të kësaj kontrate unë kisha kërkuar që ky propozim të shtyhet dhe ti ipet mundësia edhe për një periudhë të caktuar .

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-Unë kam bisedu më këtë pronar e kam njoftuar se kontrata do t'i nderpritet, nuk ju ka përmbajhtë kontratës, komisioni e ka konstaur këtë nuk është e vërtetë ajo që po deklaroi Kiqina.

PETRIT GASHI-Kerkoj që ky propozim-vendim të hidhet në votim secili që nuk përmbush obligimet sipas kontratës prona t'i kthehet komunës.

BURIM BUJUPI-Unë e përkrahu këtë propozim vendim dhe kërkoj që të votohet
LABINOT HALILAJ-Hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës:

Më rastin e votimit prezent ishin:27 anëtarë, rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:26 anëtarë, kundër:01, dhe abstenim 0.

LABINOT HALILAJ-Hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës:

7.Propozim-vendimi për kthimin e pronës komunale të dhënë në shfytëzim të përhershëm pronarit Hajdar Heta nga Glllogoci.

VEHBI BERISHA-rreth këtij propozim-vendimi unë kam vrejtje unë e kam parë edhe propozim-vendimin edhe arsyetimin e këtij propozim-vendimi ka tendencë rreth këtij rasti askund nuk tregohet se këtij pronari i janë marrë paraprakisht dikund rrethë 29 ari dhe si kompenzim ju ka ndarë kjo parcel prej 4.5 ari, prona është në shfytëzim të përhershëm gjykata ia ka njoftë të drejtën pse këto çështje nuk janë regjistru në arsyetim, janë vendimet e gjykatës se apelit.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-Nuk është ashtu Vehbi ku janë vendimet nuk ka vendime.

VEHBI BERISHA-janë vendimet në bazë të vendimeve e ka regjistru agjencioni kadastral

PETRIT SINANI-Kërkoj që kur ka vendime të prera të gjykatave duhet të respektohen, kur disa vendime janë në procedurë gjyqësore ne nuk kemi të drejtë të merremi më këto çështje derisa të përfundon procedura gjyqësore.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-Kërkoj nga kryesuesi që ky propozim të hidhet në votim gjithqka kemi shku sipas procedurave.

LABINOT HALILAJ-Hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës;

Më rastin e votimit prezent ishin: 30 anëtarë, rezultati i votimit ishte si vijon: Për:20, kunder:04 dhe absteni 06.

LABINOT HALILAJ-Hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës:

8.Propozim-vendimi për kthimin e pronës komunale të dhënë në shfytëzim të përhershëm pronarit Zejnullah Strumcaku nga Abria e Eperme

Në këtë rast Kryesuesi i njoftoi se bëhet fjalë sikurse me rastin e mehershem që diskutuam dhe pasi nuk pati diskutime.

LABINOT HALILAJ-Hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës:

Me rastin e votimit prezent ishin 30 anëtarë: rezultati i votimit ishte si vijon: Për: 20, kunder: 01 dhe abstenim: 09.

LABINOT HALILAJ-Hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës:

9.Propozim-vendimi për ndarjen e pronës komunale për varrezat e fshatit Korroticë e Ulët

SABRIJE KUKAJ-Unë kam informacione se nga MAPL-ja vendimi i aprovuar në mbledhjen e kaluar është kthyer në rishqyrtim, kërkoj që ne të kemi nga një kopje të atij vendimi të MAPL-së e pastaj diskutojmë.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-Fshati Korroticë kanë nevojë të jashtëzakonshme të caktohet lokacioni për varreza ne i kemi evidentu tri parcela dhe ju kemi propozu juve, ku ju të vendosni ne mund pastaj të hedhemi në votim se për cilën parcel po vendosni, sa i përket vendimit që e kemi marrë më heret ai vendim është i drejtë por janë manipulë edhe ministria me dezinformata por për këtë qëllim ne kemi biseduar dhe i kemi njoftuar ministrinë me gjendejen faktike që qëndron dhe se shpejti e presim përgjigjen, por unë ju kisha propozu për parcelen që ka rrethë një hektarë është shumë vendi i mirë që i plotëson nevojat e fshatit për varreza pra parcela me nr.522.

PETRIT GASHI-Unë jam kundër të gjitha atyre vendimeve që nuk kanë kaluar me shumicë votash për komitetin për politikë dhe financa nuk i përkrahu, dhe kërkoj që ky propozim vendim të shtyhet për një mbledhje tjetër.

LABINOT HALILAJ-I njoftoi anëtarët e kuvendit se të gjitha propozimet që kanë para vetës janë diskutuar në komitetin për politikë dhe financa, por një gjë duhet kuptuar të gjithë rendin e ditës e cakton sipas ligjit Kryesuesi në këtë rast unë se bashku me Kryetarin e Komunës, komiteti japë rekomandime nuk merrë vendime.

PETRIT GASHI-Mirë pra nese komiteti merrë rekomandime pse ne si kuvend nuk i kemi rekomandimet e komitetit për politikë dhe financa

SABRIJE KUKAJ-Ne sot kemi dy dokumente që duhet t'i shqyrtojmë, rishqyrtimin që ka kërkuar ministria si dhe propozimin që tjetër për caktim të lokacionit për varreza të fshatit Korroticë e Ultë, por kjo landë është në Gjykatë, përderisa landa është në gjykatë ne guxojmë të meremi me këtë çështje, unë kërkoj që të presim për këtë çështje jo të marrim ndonjë vendim të gabuar

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-gjykata ka kerku një masë të sigurisë nuk ka vendos asgjë

BEQIR KIQINA-Sa i përket këtij propozim-vendimi për caktim të lokacionit për varrezat e fshatit Korroticë e Ultë, kërkoj që të respektohet vendimi i MAPL-së për rishqyrtim të këtij vendimi, ndërsa sa i përket propozimit që kemi para vetës kërkoj që të shtyhet të presim derisa gjykata të marrë një vendim.

SHQIPE ZOGU-Sa i përket propozim-vendimit për caktim të lokacionit për varreza të fshatit Korroticë e Ultë është nevojë e banorëve të këtij fshati, grupi parlamentar i PDK-së e përkrahë këtë propozim vendim dhe ne propozojmë që parcela prej një hektari më nr.522 të hidhet në votim.

FLORENTINA ELEZI-Unë edhe në komitet për politikë dhe financa kam kërkuar që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet, ashtu është vendos edhe me shumicën e votave, dhe përsëri kërkoj që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet.

SOKOL BYLYKBASHI-Ne e dimë të gjithë se sa i përket çështjes se varreazave të fshatit Korroticë e Ultë aty ka qenë një vendim i kuvendit dhe është bërë këmbimi i pronave, por kemi edhe një vendim të gjykatës që i është caktuar një masë e sigurisë për derisa kjo çështje është në gjykatë ne nuk guxojmë dhe nuk kemi të drejtë të marrim vendim, unë kërkoj që ky propozim vendim të shtyhet dhe të presim deri sa gjykata të vendos, pastaj kemi vendimin e MAPL-së që këtë vendim e ka kthyer në rishqyrtim, si dhe peticionin e banorëve të këtij fshati ku kërkojnë që ky vendim të shtyhet se është një vendim i meherëshëm që edhe fshati e përkrahë.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-Unë kërkoj që propozimet që kam sjellë të hedhen në votim banorët e këtij fshati kanë nevojë, edhe unë propozoj që parcela me nr.522 prej një hek. i plotëson të gjitha kushtet.

ARIGON SINANI-Unë jam kundër këtij propozim-vendimi edhe fshati janë kundër nuk pranojnë që të nderrohet lokacioni, lokacioni është i caktuar me vendim të kuvendit, nuk e di si po bajka për dikan vendimi është i ligjshëm e për dikand tjetër jo, të njejtin rast e kemi në Zabel të lartë që është marrë vendim ai vendim koka i drejtë ndërsa ky vendim jo.

LABINOT HALILAJ-hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës:

Më rastin e votimit prezent ishin:29 anëtarë:rezultati i votimit ishte si vijon:Për:17, kunder: 11 dhe abstenim 01

LABINOT HALILAJ-Hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës:

10.Propozim vendimi për formimin e komisionit për rregulloren për dekorata dhe mirënjohje

SHQIPE ZOGU-Ne si grup parlamentar i PDK-së e përkrahim këtë propozim-vendim dhe në këtë rast për anëtarë të këtij komisioni propozoi:Arta Gjylanin.

BURIM BUJUPI-edhe ne e përkrahim këtë propozim-vendim ne e propozojmë nga grupi i nismas për këtë komision z.Vehbi Berisha.

ENDRIT GLLAREVA-E përkrahim këtë propozim dhe për këtë komision propozoi:z.Beqir Kiqina

LABINOT HALILAJ-Hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës:

Më rastin e votimit prezent ishin: 30 anëtarë, rezultati i votimit ishte si vijon: Për:30, kundër:0 dhe abstenim: 0.

LABINOT HALILAJ-Hapi diskutimin për pikën e njëmbdhjetë të rendit të ditës:

11.Propozim vendimin për formimin e komisionit për ndryshimin e stemës dhe vulës së komunës të Drenasit dhe harmonizimin e statutit të Komunë me ligjet në fuqi

ADEM BUCOLLI-Ne si grup parlamentar i PDK-së e përkrahim këtë propozim-vendim për formimin e komisionit për ndryshimin e stemës dhe vulës të Komunës se Drenasit dhe këto simbole të harmonizohen me ligjet në fuqi, në këtë rast nga grupi parlamentar i PDK-së për këtë komision propozoi:znj.Shqipe Zogu.

PETRIT GASHI-Nuk kam besuar kurrë dhe ende nuk po mund të besoj se ende në Drenicë ka njerëz që kundërshtojnë dhe kërkojnë të humbet identiteti ynë më gjithë sakrificat që ka pas populi ynë e në këtë rast Drenica, Historia e popullit tonë nuk fillon sot këtu por as nuk perfundon, stema dhe vula e Drenasit kanë identitet janë të gjitha elementet e kombit tonë që janë të paraqitura që nga koha e Skenderbeut e deri me dt.e 28.nentorit të vitit 1997 të daljes në skenë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosoves, e sot të kërkohet ndryshimi është fyerje jo vetëm për ne si kuvend por për të gjithë banoret e Drenasit, unë kërkoj që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës dhe kërkoj nga anëtarët e Kuvendit të mos votohet, dhe në këtë rast duhet të kemi dy të tretat e anëtarëve të kuvendit për të votuar, në vend që të merremi më papunësinë që ka kapluar vendin ne merremi si të humbim identitetin dhe të bëjmë ndryshime në vulën dhe stemën e komunës që të gjitha komunitetet tjera na kanë lakmi.

BEQIR KIQINA-Ne si AAK kemi qenë kundër edhe në komitetin për politikë dhe financa sa i përket ndryshimit dhe stemës se komunës por edhe sot jam kundër, pse të ndryshojmë kur nuk kemi as një kërkesë as nga MAPL-ja e as nga qytetaret, dhe nuk është as në kundërshtim me ligjet, pse të ndryshojmë, më mirë është ne të merremi më projekte dhe me papunësinë se sa më këtë çështje kjo ka për qëllim vetë tërheqjen e vëmendjes se qytetarëve gjoja se po bëjmë diqka a në fakt nuk merren me gjendjen që na ka kapluar në mos realizimin e projekteve.

PETRIT SINANI-Duhet trajtu si çështje të veçantë, është obligim ligjor, por ky ndryshim duhet të ndodhë por duhet të kaloj më dy tretat e votave nga anëtarët e Kuvendit, dhe të jetë në perputhshmeri me ligjet në fuqi, propozimet për këtë çështje mund të jenë tri e më tepër, por në këtë rast duhet të sqarohen çështjet.

SHQIPE ZOGU-Duhet sa për sqarim t'ju njoftoj se sot nuk bëhet fjalë për ndryshime, sot është fjala për formimin e komisionit e që ky komision mund të votohet edhe me shumicën e thjeshtë e pastaj kur komisioni propozon për ndryshime atëherë duhen dy të tretat e votave të anëtarëve të Kuvendit.

NEXHMEDEIN BALA-Unë mendoj sa i përket këtij propozim-vendimi paraprakisht është dashtë të konsultohen edhe partitë opozitare dhe nese bëhen ndryshimet të bëhen në perputhshmeri me ligjet në fuqi dhe të votohet me dy të tretat e votave të anëtarëve të kuvendit.

KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI-Unë kërkoj unitetin e të gjitha subjekteve sa i përket kësaj çështje sot formohet vetëm komisioni, ndersa për propozime i mbetet komisionit të punoj dhe të sjellë propozimet në kuvend, në këtë rast unë kisha kërkuar që këtij komisioni përveç anëtarëve të kuvendit të ketë perfaqësim edhe nga shoqëria civile.

BEQIR KIQINA-Stema e sotme dallon nga ajo kohës se Skenderbeut, nuk është e njëjtë nuk është identike ka ndryshime esenciale.

PETRIT GASHI-Unë nuk e di cila ka qenë urgjenca që të vijë ky propozim kur askush nuk ka kërkuar me ndryshu dhe askush nuk e kundërshton.

SOKOL BYLYKBASHI-Në këtë rast edhe kryetari edhe propozimet e PDK-së duke u thirrur në të kaluarën dhe në kurriz të këtij populli kjo nuk është mirë dhe të lavdrohem, për këtë vend e për të gjithë kanë kontribuar, nuk është mirë të bëjmë dallime.

SABRIJE KUKAJ-Sa i përket zgjedhjes së këtij komisioni ky duhet të jetë një komision profesional, e jo me ba hajgare me popullin pas lufte edhe emrat e fshatrave i kemi ndërruar por kurrë kjo nuk është realizuar sot kanë nga dy emra fshatrat, prandaj perzedhja e komisionit duhet të jetë profesional.

RAMIZ LLADROVCI-Nga shoqëria civile për anëtrë të këtij komisioni propozoi Ylber Hagjiu

LABINOT HALILAJ-Ftoj opozitën që të japin propozimet e tyre për anëtrë të këtij komisioni:

SHQIPE ZOGU-Pasi nuk po japin propozime anëtrë e opozite unë kam një propozim që pjesë e këtij komisioni të jetë z.Bedri Nika nga LDK-ja,

GANI PODRIMQAKU-Propozoi z.Petrin Sinani të jetë anëtarë i këtij komisioni:

LABINOT HALILAJ-hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës:

Më rastin e votimit prezent ishin: 30 anëtarë, rezultati i votimit ishte si vijon: Për:19, kunder: 10 dhe abstenim 01.

LABINOT HALILAJ-Hapi diskutimin për pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës:

12.Propozim-vendimi për financimin e projektit të HANDIKOS-it.

ARIGON SINANI-Unë e përkrahu këtë propozim-vendim fuqishëm, dhe kërkoj që vlera e propozuar prej 5.000 euro të rritet në 10.000 euro, duhet të përkrahet Handikosi, janë njerëz me nevoja të veqanta ne edhe financiarisht i kemi ndihmuar handikosin.

SOKOL BYLYKBASHI-Handikosi ka borgje, duhet të ndihmohet dhe të përkrahet edhe me ma tepër mjete edhe 10.000 mijë euro janë pak.

SABRIJE KUKAJ-Pati pyetje se qka u ba me mjete që vitin e kaluar i kemi nda hendikosit 10.000 euro, 5.000 euro ju kanë dhanë por 5.000 tjera nuk i kanë marrë arsya pse këto mjete janë mbetë pa u paguar.

ARSIM HAGJIU-Dha një arsyetim rreth këtij propozim-vendimi dhe deklaroi se për gjashtë mujorin e parë kryetari ka parapa 5.000 euro e për gjashtëmujorin e dytë është programi që parashihet të i propozojmë edhe 5.000 euro

Kryetari i Komunës z.RAMIZ LLADROVCI-Pyetjen që pati mësuesja Sabri se a do të bëhet pagesa e 5.000 euro handikosit që kanë mbetë pa u paguar po ju njoftoj se po se shpejti kjo pagesë do të kryhet.

VEHBI BERISHA-Unë e përkrahu këtë propozim-vendim për ndihmë hendikosit, kjo shumë është e vogël është, kjo çështje duhet të rrgullohet më ligjet në nivel qendror, handikosi janë në gjendje të rëndë, edhe në objektin ku janë është shumë i vjetër duhet përkrahur me të gjitha mundësit që kemi.

PETRIT SINANI-Unë e përkrahu këtë propozim-vendim por kjo vlerë e caktuar prej 5.000 euro mendoj se është e vogël kanë nevojë kjo kategori për përkrahje.

LABINOT HALILAJ-Hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës:

Me rastin e votimit prezent ishin:26anëtarë rezultati i votimit ishte si vijon;

Për:25, kundër: 0 dhe abstenim: 01

LABINOT HALILAJ-Hapi diskutimin për pikën e trembdhjetë të rendit të ditës:

13.Raporti financiar Janar-Mars 2018

PETRIT GASHI-Ky raport është një raport gjithëpërfshires, nuk ka të detajuar asgjë, më i arsyeshem ishte raporti i handikosit se sa raporti financiar i komunës, ne duhet të informohemi për çdo detaj të shpenzimeve të parasë publike e jo në këtë formë.

FLORENTINA ELEZI-Ky raport financiar është shumë i mangët, nuk ka të detajuar asgjë, nuk dihet sa është punu, çka është kry e qka jo nga projektet.

PETRIT SINANI-Është hera e parë e drejtorit të ri që po raporton, në këtë raport ka ndryshime në kalkulime dhe nuk ka fare specifikime, po të kishim një raport të mirëfillt ne më lehtë do të kishim mundësin për të diskutuar, por në të ardhmen kërkoj që raporti të jetë sa më profesional.

VEHBI BERISHA-Gjithashtu edhe unë kam vërejtje në këtë raport duhet të jetë sa më i detajuar ende është heret të flasim për përqindje se sa është kry punë e sa jo por unë kisha kërkuar që të decentralizohen shifrat dhe të kemi specifikim të këtyre shifrave

NEXHMEDIN BALA-Unë e përgëzoj komunën që ka arrit të grumbulloj borgjet, shpenzimet duhet të ndodhin por ne duhet që të kemi një raport sa më të detajuar

LABINOT GRUDA-Dha një arsyetim rreth këtij raporti, anëtarët e kuvendit i falenderoj për të gjitha rekomandimet dhe vërejtjet që i dhanë, unë do të përpiqem që herave të tjera raporti të jetë sa më i detajuar, sa i përket vërejtjeve të shpenzimet kapitale ky raport është i tre mujorit të parë dhe është ende heret të flasim për përqindje e realizimit të projekteve pasi procedurat e prokurimit marrin kohë.

LABINOT HALILAJ-Hapi diskutimin për pikën e katërmëdhjetë .

14.Të ndryshme

Në këtë rast i njoftoj anëtarët e kuvendit se në mbledhjen e komitetit për politikë dhe financa është propozuar që kuvendi të formoj komisionin për emertim të rrugëve dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të shumta që po vinë çdo ditë.

SABRIJE KUKAJ-Me sa unë e di kanë qenë tri komisione më heret që kanë punuar dhe shumica e rrugëve mbi 90%janë të emertuara dhe të përfunduara, pakënaqësi ka me pasë gjithmonë, nuk e di se ka ndonjë rrugë që nuk është emertuar, por komisioni nese zgjidhet duhet ta dijë se është një proces shumë i vështirë nuk është lehtë të punohet në këtë komision.

SHQIPE ZOGU-Nga grupi i PDK-së për këtë komision propozoi: Bekim Lestrani dhe Kimete Bardhi

NEXHMEDIN BALA-Nga grupi nisma propozoi Burim Bujupi

FITORE MORINA-Propozoi z.Gentrit Gerguri nese lejohet është kandidati në radhë nga vizioni që do ta zëvendësoj z.Xhavit Drenori

PETRIT SINANI-Propozoi z. Petrit Gashi

EDOLINA PLAKIQI-Ky komision duhet të formohet, këtë propozim e kam dhënë edhe në komitetin për politikë dhe financa, ka kërkesa dhe ankesa të shumta rreth emertimit të rrugëve po nisem prej fshatit tim aty kemi shumë problem me emertim të disa rrugëve e që duhet zgjidhur

VEHBI BERISHA-Nese zgjidhet ky komision duhet t'i ipet një mandat, dhe duhet caktuar detyrat që ka me i kry ky komision.

BURIM BUJUPI-Këtij komisioni duhet t'i ipet mandat me mandatin e anëtarëve të kuvendit është e vërtetë që ka ankesa të shumta edhe në fshatin Arllat, është vendos një rrugë me emrin e mësuesve në një lagje a kurrë mësues në atë lagje nuk ka pasur.

SABRIJE KUKAJ-Në kohën kur unë kam punuar në këtë komision të gjitha rruget janë emertu dhe nuk kemi pas problem, perveq në fshatin Nekoc që këto problem i kanë krijuar vetë anëtarët nga ky fshat.

RAMIZ LLADROVCI-Ka rrugë pa tabela për shkak se e kemi humbur donacionin, se nuk ka rrugë që nuk është emertuar.

PETRIT GASHI-Edhe në fshatin Llapushik ka ankesa, ka gabime të shumta që kanë bërë komisioni i meherthem, ky komision duhet të zgjidhë dhe duhet të jetë me mandate dhe të pyetet edhe fshati e jo me vendos pa pelqimin e fshatit.

NAIM GJELI-Edhe unë kërkoj që të formohet ky komision, dhe të ketë mandat deri në përfundimin e mandatit të anëtarëve të kuvendit se ka ankesa të shumta e që duhet zgjidhur.

ADEM BUCOLLI-E përkrahu edhe unë formimin e këtij komisioni se ka ankesa të shumta por ky komision kur të zgjidhet të bashkëpunoj edhe përfaqësues të fshatrave në mënyrë që të mos ketë problem.

LABINOT HALILAJ-Hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës më rastin e votimit prezent ishin 30 anëtarë:rezultati i votimit ishte si vijon: Për:30, kunder: 0 dhe abstenim: 0

SHQIPE ZOGU- I njoftoj anëtarët e kuvendit se grupi i grave asambleiste ka mbjatur mbledhjen e radhës dhe është bërë zgjedhja e kryesisë se re ku Kryesuese është zgjedhë znj.Arta Gjylani.

LABINOT HALILAJ- mbylli këtë seancë rreth ores 16 e 30 minuta

Proces mbajtësi:

Xhavit Nebihi




Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:

Labinot Halilaj



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. _____ dt. _____ 2018

**Mbledhja e rregullt
Kuvendi Komunal
27.06.2018**

PROCESVERBAL

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më
datë.27.06.2018

Mbledhjen e kryesoi: **LABINOT HALILAJ** – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të rregullt të Kuvendit Komunal ku të pranishëm ishin 27 anëtarë

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

- 1.Procesverbali i datës 29.03.2018 dhe Procesverbali i datës 04.05.2018
- 2.Propozim Vendim për shfuqizimin e vendimit nr.421/281 të datës 18.01.2008, në të cilën është dhënë objekti i qendrës së komunitetit në Glllogoc në shfrytëzim qendrës Dielli.
- 3.Propozim Vendim për kthimin e pronës komunale në zonën Kadastrale në Komoran të cilën e ka pasur në shfrytëzim Naser M. Gashi në Komoran.
- 4.Propozim Vendim për kthimin e pronës komunale në zonën Kadastrale në Komoran të cilën e ka pasur në shfrytëzim NTP "MALI-COM" në Komoran.
- 5.Propozim Vendim për dhenjen në shfrytëzim afatgjatë të pronës Komunale nr.295/12 me sipërfaqe S=0.53.00ha Zona kadastrale Sankoc, për varrezat e fshatit Sankoc.
- 6.Projekt – Rregullore për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në territorin e Komunës së Drenasit.
7. Propozim Vendim për ridestinimin e mjeteve nga mbetjet e projekteve Kapitale.
- 8.Draft Korinza afatmesme buxhetore Komunale 2019-2021.
- 9.Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Drenasit për vitin 2017.
- 10.Raporti i Përformancës Komunale.
- 11.Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj, Hapi mbledhjen e Kuvendit.

Gani Podrimqaku, para se të fillojmë me rendin e ditës, unë kam një propozim në emër të grupit parlamentar të PDK-së në bazë të rekomandimit 8 të zyrës së auditimit kryetari duhet të siguroj se është bërë plotësim ndryshimi i rregullores për menagjimin e subvencioneve andaj ne propozojmë si pikë të rendit të ditës, ndryshimin e rregullores nr.12-320-19338 të datës 07.04.2017, për kushtet, kriteret dhe proceduar e ndarjes së subvencioneve, të hynë si pikë e rendit të ditës.

Sokol Bylykbashi, unë kam një propozim por paraprakisht dua ta arsyetoj, në fillim të mandatit kemi tentuar m'i mbajt tri mbledhje të jashtëzakonshme në Kuvendin Komunal ku në ato tri mbledhje ka qenë një pikë e rendit të ditës për punësimet me baza klanore dhe politike, por nuk janë mbajtur. Sot po flas për rastin e Albulena Bujupit. Albulena Bujupi ka qenë e sjellshme me të gjithë dhe ka qenë e zellshme në punën e saj. Asaj iu ka ndërprerë puna me baza klanore partiake. Unë kërkoj një dokument vlerësues, komuna gjithëherë bënë dokumente vlerësuese, por nuk e di se çfarë statusi të punës ka qenë, a ka pas kontratë çdo herë nga një vit, apo si. Unë paralajmëroj kryetarin le të vazhdon kështu unë do të filloj një analize, për të nxjerrë një raport që ka me qenë shumë bindës për të gjithë. Unë kam një propozim si pikë e veçantë e rendit të ditës, për problemin e punësimeve klienteliste.

Kryetari i Komunës-z.Ramiz Lladrovci, mund të flas me respektim më të madh për Albulena Bujupin, asnjë vërejtje nuk e kam pas asnjëherë, vetëm vërejtje që kanë qenë të asamblistëve keni thënë proces verbalet po bëhen me gabime drejtshkrimore. Albulenës i ka përfunduar kontrata jashtëligjshme edhe disa zyrtarëve tjerë, unë nuk vazhdojnë vendime të jashtëligjshme askujt, kuvendi nuk vendos për vende të punës, unë nuk vazhdoj vendime të jashtëligjshme, profesorët që janë me bachelor me nga 180 kredi nuk i lejon ligji me punu vetëm nëse nuk ka kuadër me master, kanë pas mundësi prej vitit 2015 deri 2018 ia ka dhënë mundësin shteti me e përfunduar masterin por nuk i kanë përfunduar, por nuk i largoj unë nga puna askënd por ligji e largon, filloni sipas ligjit. I ftoj asamblistët ta votoni atë pikë të rendit të ditës.

Sabrije Kukaj, asnjë asamblist nuk ka pas vërejtje për Albulena Bujupin, ajo ka qenë një punëtore e sinqertë. Po flas edhe për rastin e Mihrije Gjokaj, të cilës është dashtë për t'i ndihmuar për një pension invalidor sepse ka qenë punëtore këtu.

Kryetari i Komunës-z.Ramiz Lladrovci, Albulena Bujupin nuk e kemi larguar për vërejtje apo ndonjë arsye tjetër, por i ka përfunduar kontrata e jashtëligjshme, nuk kemi pas të drejtë për ta vazhduar kontratën dhe nuk kam asnjë vërejtje për të, ndërsa për Mihrijen nëse një zyrtar i Komunës mungon më shumë se tri ditë pa arsye ai largohet nga puna, dy vite ka marrë pagë prej shtetit Mihrija pa qenë asnjë ditë në punë dhe pa e sjellë asnjë vërtetim mjekësor dhe ne i kemi ndihmuar aq sa kemi pas mundësi por nuk kemi të drejtë që ta mbajmë një punëtor që nuk ka ardhë në punë dy vite, ligji nuk e lejon këtë unë e kam zbatuar ligjin dhe do ta zbatoj.

Beqir Kiqina, vërejtjet që i kemi pas për Albulenën disa nga ne asamblistët për drejtshkrimin

nga Sekretaria e Kuvendit më shumë ato vërejtje i kemi pas si rekomandim si duhet ta punoj një proces herëve të tjera dhe nuk kemi pas vërejtje tjetër.

Kryesuesi- Labinot Halilaj, e kemi një propozim vendim për plotësimin dhe ndryshimin e ambullës që e kemi nxjerrë më herët si kuvend për shpronësimin e pronës së paligjshme, të ndërtimit të Qendrës së Mjekësisë Familjare në Komoran është dashtë me qenë, ndërsa është bërë gabim me qellim të ndërtimit sintetik. Pika tjetër për plotësim ndryshimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve, dhe pika fundit për punësime klienteliste.

Kryetari i Komunës-z.Ramiz Lladrovci, Ky është një rekomandim i auditorit, për plotësim ndryshimi e rregullores për kushtet, kriteret dhe proceduar e ndarjes së subvencioneve, unë kam kërkuar mos me dhënë asnjë cent në subvencione, me dhënë komisioni dhe kuvendi, por auditori që nuk ka të drejtë ka rekomanduar që duhet me pas një shifër që kryetari në raste të jashtëzakonshme pa e kaluar përmes komisionit ose pa e kaluar përmes kuvendit me pas drejt me dhënë subvencione, po e zbatojmë një rekomandim të auditorit dhe ne duhet me pas një shifër

Beqir Kiqina, unë nuk jam kundër këtij propozimi por është mirë që materiali me u studiu ma herët, kjo pikë e rendit të ditës të vijë ma herët dhe së pari të shkoj nëpër komitet pastaj të vij këtu.

Kryesuesi Labinot Halilaj, rendit të ditës iu bashkëngjitën edhe tri propozime, në emër grupit parlamentar, 1.Ndryshimin e rregullores nr.12-320-19338 të datës 07.04.2017, për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, 2. Punësimet klienteliste në Komunën e Drenasit, 3.Plotësim ndryshim të ambullës të mbledhjes se kaluar.

Shqipe Zogu, përderisa nuk marrim vendim për një qeshje nuk më duket e arsyeshme përderisa pika e kolegut është vetëm diskutim mjafton të kaloj të të ndryshmet dhe aty mund ta diskutojmë. Ndërsa për kartela nuk është në rregull nëse vetëm një herë kemi të drejte ta vendosim kartelën dhe nuk kemi drejt me lëviz, ne mundemi me bë lëvizje gjatë ditës dhe është shumë e padrejtë me pas drejtën dikush mundësin e manipulimit.

Kryesuesi-Labinot Halilaj, hodhi në votim rendin e ditës: *27-anëtarë ishin prezent.*

Për votuan: 26

Kundër: 00

Abstenim: 00

Kryesuesi- Labinot Halilaj,Hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1.Procesverbali i datës 29.03.2018 dhe Procesverbali i datës 04.05.2018

Petrit Gashi, shumë herë, kundervenjet e kryetarit ndaj asamblistëve nuk po i paraqitni në proces verbale, është mirë që edhe ato t'i paraqitni në proces verbale.

Burim Bujupi, pajtohem me z. Gashin mendoj që herëve të tjera fjalimet të futen komplet.

Petrit Sinani, përshkrimi im nuk është shënuar as 10% kërkoj të jetë në proces verbal.

Kryesuesi-Labinot Halilaj, proces verbali është një rrumbullaksim i diskutimeve të asamblistëve nuk është përshkrim i plotë i çdo diskutimi që bëni për këta quhet proces verbal, e rëndësishme është koncepti i diskutimit tuaj me qenë në proces verbal por vetëm një përmbledhje e shkurtër.

Arigon Sinani, mundeni me kërkuar transkripton e mbledhjes për proces verbal aty mundeni mi pa gjitha detajet, proces verbali është vetëm përmbledhje e mbledhjes.

Kryesuesi- Labinot Halilaj-Hodhi në votim pikën e parë të rendit të ditës:

Për votuan: 23

Kundër: 00

abstenim: 00

Kryesuesi- Labinot Halilaj, Hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2.Propozim Vendim për shfuqizimin e vendimit nr.421/281 të datës 18.01.2008, në të cilën është dhënë objekti i qendrës së komunitetit në Glllogoc në shfrytëzim qendrës Dielli.

Vehbi Berisha, ky propozim më duket ndryshe nga të tjerat, edhe pse në një mënyrë jam për, por ka shume paqartësi, kërkoj sqarime nga drejtoret e dikastereve përkatëse. Pse nuk po bëhet një praktikë që kur të na sjellët një propozim vendim si kësaj natyre me ia bashkëngjit edhe vendimin që u marre atëherë në vitin 2008. Që me ditë edhe ne si asamblist se çka u marrë vendim atëherë, pastaj ka shumë paqartësi të kjo, se kur iu ka dhënë karitasit zviceran thotë iu ka dhënë për periudhën 2014-2017, prej 2017 deri tani kush e ka menagjuar këtë qendër. Unë jam për që kjo qendër t'i kthehet komunitetit rinor, por kisha kërkuar një sqarim me shumë kush mundet me e dhënë nga ekzekutivi.

Sabrije Kukaj, janë dokumentet në Drejtorinë e Arsimit në Drenas apo diku tjetër, qendra është nderuar nga francezet me projekte shoqatës "Shpresa" kur kam qene unë drejtorë ekzekutiv shoqatës arlleora sektorit Rinis dhe Drejtorisë se Arsimit ne kemi qenë 4 përfaqësues, ne e kemi krijuar një bord e kemi shpallë një konkurs për me marrë një drejtor të bordit, me qenë një staf menagjues i qendrës për aktivitete të rinis, shoqata e gjitha, ndërkohë komuna e ka marrë objektin kur konkursi është mbyllë dhe njerëzit kanë konkurruar për drejtor të bordit, e kanë anuluar konkursin dhe komuna apo Drejtoria e Kulturës e ka marrë objektin dhe kanë filluar me aktivitete rinore, nuk kemi thënë asgjë për arsye që mirë si është ndërtuar objekti, projektet tona nga francezet, se paku le të shfrytëzohet nga dikush. Fillimi i ndërtimit të qendrës është i katër institucioneve i dy OJQ-ve, i sektorit të rinisë, dhe Drejtorisë se Arsimit. Mirë është me marr vendim që qendra me u shfrytëzua në të mirë të komunitetit, por duhet me qenë një projekt përpara si ka mu shfrytëzuar, kush ka me menagjuar, kush ka me qenë aty për shfrytëzim.

Petrit Gashi, sa i përket këtij materiali është jo i kompletuar në të cilën na jep një mundësi ta shikojmë në të vërtetë se çfarë do të votojmë. Mungon propozim-vendimi 18.01.2008 për të ditur të drejtat dhe detyrimet e kësaj kontrate, ndërmjet dy palëve dhe ne nuk kemi një arsyetim të qartë se cili është qëllimi se kaq shpejt të bartet prej një drejtorie në një drejtori tjetër. Nuk do ta votoj asnjë propozim që është i cunguar në informacion, do ta abstenoj këtë propozim vendim sepse nuk ka material të mjaftueshëm për të na bindur ne për të votuar.

Fitore Morina, nga ne sot po kërkohet që të shfuqizohet një vendim përkatësisht vendimi nr. 421/281 data 18.01.2018, para dhjetë viteve me të cilin vendim është arritur marrëveshja ndërmjet komunës sonë dhe karitasit zviceran për shfrytëzim nga këta të fundit për periudhën 2014/2017. Çfarë ka ndodh me këtë objekt prej vitit prej 2008 deri 2014 dhe çka do të ndodh me fëmijët që janë aty?

Florentina Elezi, kjo pikë e rendit të ditës ka ardhë në Kuvend pa rekomandimin për Politikë dhe Financa, se ne jemi për me ia dhënë një vend rinis së Drenasit por parashkolloret mos po mbesin pa vend.

Kryetari i Komunës-z.Ramiz LLadrovci, prej 1 shtatorit funksionale do të jetë shkolla në Poklek të Vjetër, shkolla fillore "Rasim Kiqina" do të lirohet nga numri i madh i nxënësve do të përgjysmohet dhe vend kemi pastaj të mjaftueshëm, dhe nuk do të mbetet asnjë fëmijë pa klasë, ne gjithë atë objekt nuk e mbajmë për një klasë ose dy, sikur mos me pas, kemi vend të mjaftueshëm, por objektin e kemi kërkuar me ju kthye atyre që iu ka destinua për atë qëllim që është ndërtuar, objektin jemi duke e lëshuar për rininë tonë për OJQ-në dhe në veçanti për KVRL-në.

Vehbi Berisha, nuk jemi kundër këtij propozim vendimi por mos me këtë vendim që do ta votojmë për, mos po e mbyllim një etapë të erret të dallaveve që kanë ndodhur në atë qendër

Kryesuesi-Labinot Halilaj,Hodhi në votim pikën e dytë të rendit të ditës:

Për votuan: 16

Kundër: 01

Abstenim: 09

Kryesuesi-Labinot Halilaj, Hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3.Propozim Vendim për kthimin e pronës komunale në zonën Kadastrale në Komoran të cilën e ka pasur në shfrytëzim Naser M. Gashi në Komoran.

Petrit Gashi, sa i përket këtij propozimi për kthimin e pronës komunale në zonën kadastrale në Komoran, mendoj se ka shumë parregullsi në këtë dokument që e kemi dhe nuk na bind fare që ky propozim vendim duhet të kalojë. Secili e keni lejen para jush, kemi fotot e objektit të ndërtuar

që nuk është në parcele, unë nuk do ta votoj këtë propozim vendim dhe ju bëj thirrje gjithëve që mos ta votoni këtë propozim vendim, kërkoj nga ju që të paktën me ia dhënë një mundësi atij njeriu dhe ta shohim se çka është në gjendje me bë kryetari. Personi në fjalë e ka pronën për 40 vite, kanë kaluar 4 vite, për shkak të probleme të ndryshme shëndetësore të cilat i ka paraqitur kryetari, ai nuk ka mundur për të ndërtuar mirëpo në momentin që iu ka dhënë leja a mos po bëheni edhe ju pjese e shkeljes së ligjit, nëse kanë kaluar 18 muaj është dashur me sjellë në kuvend dhe me e shfuqizua atë vendim.

Kryetari i Komunës-z.Ramiz Lladrovci, kush do që ka dhënë leje për një kontratë që e ka lidh kontratori me komunën, dhe nuk i ka përmbush kushtet e kontratës, për vendimin që ai nuk iu ka përmbajt për 18 muaj, çdo kush që nuk e respekton kontratën kush nuk e kryen projektin që lidh kontratë me komunën brenda afatit ligjor iu ndërpritet kontrata ligjore, kërkoj që këto dy propozim vendime të shtyhen dhe t'i tërheq, dhe ju keni të drejtë t'i ndjekeni gjitha proceduar ligjore. Kërkoj me i largu prej rendit të ditës dy pikat e 3 dhe 4.

Petrir Gashi, jo vetëm të shtyhet kjo pike e rendit të ditës por duhet me gjetë një hapësirë ligjore që me pa ai, që a i ka përmbush kushtet apo jo, personi në fjalë i ka paguar gjitha obligimet i ka vetëm për vitin 2018, deri me 31 dhjetor 2018 nuk ka kurrfarë obligimi.

Kryetari i Komunës-z.Ramiz Lladrovci, ne do t'i shikojmë të gjitha, dhe do të dalim me raport, unë mbaj përgjithësi politike. Naseri ka pas me investu 150 mijë euro brenda 18 muajve dhe me i punësuar 9 veta në punë, që u dashtë që 2 vjet e me shumë ai u dashtë me i pas 9 punëtor dhe me qenë objekti i ndërtuar, por ka mbete ashtu.

Beqir Kiqina, këto prona që ne i kemi votuar disa për mi marre, edhe do t'i votojmë të gjithë që nuk i kanë respektuar kushtet e kontratës mirëpo këtu nuk po ka bashkëpunim siç përfshihen organet kompetente ligjore as me ministrinë e pushtetit lokal e as me organet tjera, në qoftë se ne e marrim një pronë dhe nuk e kemi respektuar kushtet e kontratës atëherë çka me vepru komuna. Naser Gashi e kishte marrë një tok në shfrytëzim për 40 vjet dhe ka sjellë disa fotografi se diçka është ndërtuar këtu, është mirë të mos jemi të pasigurt. Ndërtimet që janë bërë më herët është mirë me u konsultuar edhe me na dhënë sqarime me shumë e me ditë edhe ne se çka është.

Kryetari i Komunës-z.Ramiz Lladrovci, nuk bëj veprime kundër përfaqësuesve subjekteve politike. Çdo kush që nuk e ka përmbush kontratën, kontrata iu ndërkrehet nëse nuk i përmbush kushtet e kontratës. Kërkoj me i tërheq këto dy pika të rendit të ditës.

Adem Bucolli, nuk jam për ta dëmtuar asnjë investitor real që i përmbush kushtet e kontratës, jam ihtar i asaj që çdo herë ai person i cili merr një prone komunale, çdo investitor që nuk i përmbush kushtet e kontratës t'i merret e ajo pronë dhe t'i jepet ndokujt që e zhvillon atë

veprimtari e jo të zvarritet qysh po manipulohet kështu.

Petrit Gashi, nëse pas 18 muajve nuk i ka përmbush kriteret të cilat janë të shkruara në kontratë është dashtë me ia marrë atë pronë.

Adem Bucolli, vendimi nuk iu ka përmbush kushteve të kontratës dhe unë jam ithtar i asaj i cili nuk i përmbush kushtet e kontratës me iu marrë prona.

Kryetari i Komunës-z.Ramiz Lladrovci, unë po e mbroj pronën e komunës dhe do ta mbroj deri fund.

Sabrije Kukaj, nuk i kam të qarta disa gjera, na e japin pronën por kontratën në bazë të konkursit të komunës, kontratën e bënë kryetari i komunës, nëse kërkuesi i pronës nuk i përmbush kushtet e kontratës pronën mundet me kthye në komunë ndërsa punën mundeni me ia ndal. Ne Gllobar e keni pronën që ia kanë dhënë në skaje të asfaltit shikoje edhe atë prone pak, nuk ka ardhë në kuvend kurrë, dhe nuk është bërë ndërrimi përmes kuvendit.

Burim Bujupi, sa i përket manipulimeve që i përmendi z.Bucolli nuk e di kush është manipuluar, por më se shumti është manipuluar ekzekutivi, këtu i kemi dy leje ndërtimore një në vitin 2016, edhe tjetra në 2017, këtë nuk po e kuptojmë leje mbi leje.

Petrit Sinani, sa i këtij propozimi me shiku kontratën në tersi dhe është e pamundur për ta realizuar, se ia keni dhanë 10 ari për 40 ditë me prodhues beton, operativ ndërtimore, por nuk ka mundësi 10 ari me prodhues beton, këto dy pika të rendit të ditës është mirë me u shty.

Kryetari i Komunës-z.Ramiz Lladrovci, nëse jeni të pajtimit kjo pikë me u shty sepse dy leje ndërtimi për një vend brenë 6-8 muajve nuk është e ligjshme. Me 23.07.2016 ka kërkuar aneks shtesë objekt me ndërtu me sipërfaqe 150.12 m ndërsa në prillin e 2017 ka kërkuar shtesë aneks për sipërfaqe prej 50 m, ai sipas ligjit është dashtë me ndërtuar se paku 60% të objektit dhe me perfundu në muajin afër e 06.2016 dhe pastaj nëse i ka arrit mundësit me investuar, ka mundur me kërku leje nëse i ka plotësuar kushtet.

Labinot Halilaj, Hodhi në votim pikën e 3 dhe 4, për propozimin 3 dhe 4 këto pika të rendit të ditës të shtyhen për një seancë të radhës.

Për votuan: 26

Kundër: 00

Abstenim: 00

Kryesuesi-Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Propozim Vendim për dhenjen në shfrytëzim afatgjatë të pronës Komunale nr.295/12 me sipërfaqe S=0.53.00ha Zona kadastrale Sankoc, për varrezat e fshatit Sankoc.

Prezent ishin 29 anëtarë

Kryesuesi-Labinot Halilaj, hodhi në votim pikën e pestë të rendit të ditës:

Prezent ishin 29 anëtarë:

Për votuan: 29

Abstenim: 00

Kunder: 00

Kryesuesi-Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Projekt – Rregullore për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në territorin e Komunës së Drenasit.

Sokol Bylykbashi, më vjen mirë që ka ardhë një rregullore që merret me qeshjet e varrezave, kam kërkuar që komuna Drenasit, konkretisht Drejtoria për Shërbime Publike dhe emergjente me angazhu një kompani me u marrë me mirëmbajtjen dhe rregullimin e tyre. E kam një pyetje drejtoria a i ka taku përfaqësuesit e Këshillit të Bashkësisë Islame a ka pas kontakt me ta se paku me marrë një mendim, ose a kanë pasur ata ndonjë propozim nëse iu ka taku për shkak se kjo Bashkësi dihet se i udhëheqin procedurat fetare.

Petrir Gashi, ky është ndër projektet më të mira që po bëhen në Drenas, por e kam një shqetësim për fshatin Llapushnik dhe varrezat tona datojnë së paku që 120 vjet dhe tani është dal pronë private, a e keni paraparë që atë tok ta ktheni në pronë publike, si është e mundur që kjo tok të jetë në emër të një personi privat.

Burim Bujupi, dua të ndërlidhem të neni 15 pika 2. Shpenzimet për shërbime të varrimit kryhen nga Komuna nga kategoria e subvencioneve, ose kategoria (mallra dhe shërbime) e buxhetit të komunës. Nga kategoria për subvencione kisha pas dëshirë me lekë dhe me krye të gjitha nga mallra dhe shërbime për shkak mos me lënë të subvencionet sepse po reduktohet buxheti i subvencioneve.

Kryetari i Komunës-z.Ramiz Lladrovi, e keni rekomandim të auditorit që nuk mundemi mallra dhe shërbime por duhet nga subvencionet. Kjo projekt rregullore i ka përfunduar gjitha procedurat para se me ardh në kuvend ka qenë në dëgjim publik i ka taku bashkuesit fetare, kanë konsultuar me qytetarët kështu që nuk ka mbet asnjë procedure pa e përfunduar.

Burim Bujupi, a ka mundësi herëve të tjera në qofte se i njoftojmë qytetarët dhe shpenzimet e varrimit të kryhen në bazë të subvencioneve me dal komuna me thënë se këtë vit nuk kemi subvencione dhe nuk kemi mundësi me i krye shpenzimet e varrimit.

Kryetari i Komunës-z.Ramiz Lladrovci, jo vetëm për shpenzimet e varrimit por edhe shumë shpenzime tjera nëse nuk ka buxhet, ligji nuk na detyron me i pagu, kështu që nëse nuk ka buxhet nuk ka heqje te shpenzimeve.

Vehbi Berisha, ky është një lajm i mirë ne do ta votojmë sepse ky është një lajm i mirë për të gjithë qytetaret e Drenasit.

Beqir Kiqina, a përfshihen këtu dy kategoritë edhe të dëshmorëve edhe të varrezave për shkak të vdekjeve natyrale, pasi ka pas shumë kërkesa nga qytetaret që varrezat nuk janë në gjendje të mirë të mirëmbajtur, nëse nuk është përfshi edhe kjo kategori është mirë të përfshihet.

Kryetari i Komunës-z.Ramiz Lladrovci, *Sqarim*, për ndryshimin te neni 15 pika 2, shpenzimet do të hekën nga mallra dhe shërbime jo prej subvencioneve. Ne nuk i kemi përcaktua cilat varreza mirëpo e kemi një institucion i cili kujdeset për mirëmbajtjen e gjitha varrezave mirëpo në prioritet janë varrezat e dëshmorëve.

Arta Xhylani, si do të bëhet shpronësimi ose rregullimi i atyre varrezave që kanë probleme me prona private siç është në Komoran, dhe ka probleme me vendin e varrimit sepse nuk ka hapësire të mjaftueshme për varreza.

Kryetari i Komunës-z.Ramiz Lladrovci, sa i përket pronave private që i kanë lëshuar pronarët e pronave, gjyshërit apo stërgjyshërit e pronës për varreza tash po kërkojnë nipat me ia kompenzu ato prona.

Kryesuesi-Labinot Halilaj, Hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës:

Prezent ishin 29, anëtarë.

Për votuan: 29

Kundër: 00

Absteni: 00

Kryesuesi-Labinot Halilaj- Hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Propozim Vendim për ridestinimin e mjeteve nga mbetjet e projekteve Kapitale.

Drejtori për Urbanizëm Idriz Hysenaj, ridestnimi shtesë pika 3, të cilat me i bart mjetet prej pikës 8 ne 3, këto janë mbetje të projekteve që këtë vit janë lidh kontratat , këto kemi mënduar mu bart në dy projekte të cilat janë me të mbetura mbrapa duke filluar nga fshati Nekoc dhe

Negrovci janë fshatra të mëdha të cilat kanalizimi ka mbetur mbrapa, për me zvogëluar numrin e projekteve kemi mëndur mi bërt këto. Nga pika 8 kalon në pikën 3, asfaltimi i rrugës në fshatin Çikatovës së vjetër që është projekt i lidhur në kontrat me një operator i lë për dy fshatra edhe Dobroshefc edhe Çikatovë mjetet njërtën kanë dal mungesë ndërta tjetra shtesë. Gabim teknik fshati Nekovci të jetë Negrovci ndërta fshati Negrovci në Nekoc, shumati i kemi të për afërta ia kemi ndërta vendet, gabim këto projekte janë në realizim e sipër.

Shqipë Zogu, a përfundon kanalizim këto dy fshatra?

Idriz Hysenaj, jo nuk përfundojnë të gjitha sepse janë fshatra të mëdha.

Petrit Gashi, Në Llapushnik ka pas mjaft kanalizim mirëpo kanë tēpruar edhe 8320 euro dhe është kanalizimi prej 650 m në lagjen Haradinaj që ka mundur me u pērfund me këtë kod, pasi që në Nekovci edhe Negrovci nuk janë pērfunduar projektet kanë qenë mirë me e pērfund atē projekt me këto shpenzime dhe nuk kemi nevojë me hap kod të ri.

Drejtori për Urbanizëm-Idriz Hysenaj, Në fshatin Llapushnik pērfshihen Patrorki edhe Vukovci si fshat nuk është e pērfunduar dhe nuk mund të pērfundohet as me këtë projekt unë e marrë parasysh atē por duke e shikuar hartën kadastrave ujërat e fshatit Arllat, ujërat e fshatit Llapushnik kalojnë neper territorin Negrovci, në jemi duke shikuar me i grumbulluar kanalizimet në impiante të vogël.

Sabrije Kukaj, kur e kemi ndarë buxhetin gjithmonë e kemi lënë 60 mijë apo një shumë tjetër. Në fshatin Verboc i kemi lënë me qëllim që kur të pērfundon një lagje kalon në lagjen tjetër, dhe ato mjete të mbesin prapë në fshat. Unë kam kērkuar në buxhet 5 mijë euro për shkollën në Polluzhë dhe është votuar, për renovimin e kulmit dhe kockave por në buxhet ishte vetëm kulmi i shkollës mirëpo kulmi kushton psh. 900 euro ndërta kockat nuk është pērshkruar fare.

Drejtori për Urbanizëm-Idriz Hysenaj, shumata që ka mbetur në kemi planifikuar me ato oferta që kanë ardhë vitin e kaluar, por këtë vit kanë ardhë oferta me të lira dhe për atē arsye kanë mbetur këto mjete, dhe jemi pērqendruar në dy projekte me këto mjete.

Kryetari i Komunës-z.Ramiz Lladrovci, në po kērkojmë tenderët me i grumbulluar tri ose me shumë fshatra në një tender .

Burim Bujupi, Në fshatin Arllat nuk janë të pērfunduara kanalizimet edhe po i merret një buxhet në vlerë prej 9294 euro për ridestinim të mjeteve, më mirë do të ishte me u hap një tender i ri për arsye se kanë mbetur vetëm edhe 2 mijë metra kanalizim pa u pērfunduar, me shumë pak mjete keni mundur me i pērfund të gjitha.

Kryetari i Komunës-z.Ramiz Lladrovci, Tendere të ri nuk mundemi me hap se nuk ka rishikim te buxhetit, derisa nuk ka rishikim të buxhetit nuk mundemi me hap tenderua të rinj.

Bujar Dervishi, e kam një pyetje për fshatin Qikatovë e Vjetër prej cilit projekt janë apo cilat lagje janë përfunduar?

Drejtori i Urbanizmit-Idriz Hyesenaj, kjo ka qenë kontratë e vitit të kaluar që kanë përfunduar punimet, dhe në ndonjë fshat kanë mbet mjete më shumë, ndërsa ndonjë fshat më pak dhe për këtë arsye kanë mbet këto mjete.

Fitore Morina, unë jam kundër këtij ridestinimi me u marrë 15 mijë euro prej Qikatovës me kalu në Dobroshefc po me duket e pakuptueshme.

Kryesuesi-Labinot Halilaj- Hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës :

Për votuan: 17

Kundër: 01

Abstenim: 08

Kryesuesi-Labinot Halilaj-Hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës:

8.Draft Korinza afatmesme buxhetore Komunale 2019-2021.

Sabrije Kukaj, Këtu ka me pas ndryshime, por ndarja e mjeteve Drenas Komoran për kubëza dhe asfaltim po më duhet jo e mirë, 150 mijë për Komoran ndërsa Drenasi 80 mijë nuk është në rregull, Drenasi nuk është në gjendje të mirë infrastrukture dhe duhet me pas më shumë investime ne qytet, edhe për Fshatin Verbovc ka shumë pak mjete, sepse mungon kanalizimi dhe rruga është ende e pa asfaltuar.

Kryetari i Komunës -z.Ramiz Lladrovci, ju si asamblist vendosni për shpërndarjen e buxhetit, kjo ka me dal ne debat publik me qytetaret. Për ne investimet në gjitha vendet është njëjtë si në Komoran si në Drenas, të votojmë ku është më e arsyeshme dhe ku ka prioritet më shumë.

Sabrije Kukaj, e kam një propozim për ndarje te buxhetit, është mirë një grup i njerëzve bashkë me komitetin me i pas hartat, e secilit fshat përpara si një grup punues, me i shiku hartat e fshatit se çka është investua në ato fshatra dhe çka jo, me pas një pasqyrë në përgjithësi të fshatrave dhe me shikuar ku ka me pak investime me pas prioritet ai fshat .

Arta Xhylani, kërkoj një përgjigje prej drejtorit të urbanizmit për mjetet qe kanë me u shpërnda për Komoranin 1,2,3,4, dua të di për rrugën Imer Alushani a është ne vitin 2018 apo 2019, rr.Lulzim Tahiraj, rr.Mentor Morina, kërkoj një sqarim për këto tri rrugë dhe kanalizimin e

ujërave të zeza.

Kryetari i Komunës-z.Ramiz Lladrovci, e keni një dokument një kornize afatmesme buxhetore që po diskutojmë për buxhetin 2019-2021, projektet për këtë vit nuk i kemi në temë tani për buxhetin e vitit 2018.

Vehbi Berisha, këtë vit nuk është punuar sa duhet në infrastrukturë nëpër fshatra. Për fshatin Llapushnik është ndarë një shumë e vogël sepse fshati është një gjendje jo e mirë. Asfaltimi i rrugëve nuk ka përfunduar ende. Kërkoj që të rishikohet edhe një herë buxheti dhe t'i jepet aty ku ka më shumë prioritet.

Kryetari i Komunës-z.Ramiz Lladrovci, mos i ngatërroni projektet e 2018 me Kornizen afatmesme buxhetore 2019-2020 dhe 2021. Ne i kemi fituar 82 mijë euro për performancë të mirë dhe ato i kam vetëm dy mundësi ku me investo trotuarin në Godanc, Dobroshevc, Qikatovë të Vjeter, ose në tregun e gjelbër, këtë mundemi me vendos se bashku ku mundemi më investuar. Jemi duke e bërë kanalizimin e ujërave të zeza përmes kolektorëve 250 mijë euro, shumë fshatra kanë me pas zgjidhjen e proçkave të lumenjve me i hekë ujërat e zeza nga lumenjtë.

Vehbi Berisha, sa i përket Kornizës Afatmesme Buxhetore që i paraprinë trajtimit të buxhetit hapat e parë dhe fillestar ajo që më bëri përshtypje në tersi si dokument nuk ka vërejtje të mëdha, mirëpo nëse ndalim edhe e shikojmë se ku është orientuar buxheti nuk përkon me prioritetet të cilat janë përcaktuar në fillim që përmendën në tri prioritetet e para, për realizimin e këtij buxheti për shkak se shumica e prioritetëve shkojnë në drejtorinë e urbanizmit. Unë nuk pajtoj që tri ose katër fshatra të futen në bazë të një projekti, dëshiroj se kur të bëhet miratimi i buxhetit është mirë t'i definojmë saktë se sa metra ose sa km. asfalt shkojnë në Gllanasellë e sa në Godanc në mënyrë që mos të lëmë hapësirë për manipulime të këtyre projekteve kapitale. Ndërsa rregullimi i shtratit të lumit Drenica është një projekt që ka filluar që disa vite dhe ju keni planifikim mjetë deri në vitin 2021, dmth ky projekt nuk pritet me u përfunduar deri 2021. Të ndërtime të tjera të ndërtimi i parkut në Vasilevë për vitin 2021 nuk keni planifikim asgjë. Dhe të trajtimi i qeneve endacak kemi 00. Euro për vitin 2021.

Kryetari i Komunës-z.Ramiz Lladrovci, Për parkun e Vasilevës kemi bërë përpjekje të madhe me i ndarë 30 mijë euro, por liqeni dhe ajo pronë është pronë e KEK-ut, asnjë investim nuk kemi të drejte me bërë në pronë të KEK-ut, por pasi që këtë pikë po kemi dëshirë me bërë si pikë turistike kemi me u angazhu me Ministrinë e Planifikimit Hapësinor sepse edhe unë jam i interesuar për këtë projekt, por prej nivelit qendror jo prej nivelit lokal. Për qentë endacak Niveli Qendror ka me i zgjidh problemet dhe është ndarë shuma për qentë endacak nga Niveli qendror jo nga niveli lokal.

Arigon Sinani, Në Korreticë sa mjete janë të ndara për kanalizimin e ujërave të zeza dhe infrastrukturë?

Beqir Kiqina, Unë i kam disa vërejtje të vogla, parashikimet siç janë bërë a kish pas mundësi buxhetin me nda ne çdo fshat jo siç i keni planifikuar me një shumë tri fshatra.

Kryetari i Komunës-z.Ramiz Lladrovc, i kemi mbledh tri fshatra për arsye se tani nuk kanë mbet rrugë kryesore të pa asfaltuar, kanë mbete vetëm lagje, dhe buxhetin kemi me e nda të barabartë nëpër fshatra.

Shqipe Zogu, sa i përketë projekteve po ndërlidhem me fshatin Komoran nuk janë shumë 150 mijë euro sepse ende ka rrugë kryesore të pa asfaltuara, jo rrugë të lagjes.

Haka Tahiraj, për fshatin Abri kanalizimi i fshatit Abri dhe fshatit Terrdevc, kur ka qenë projektet më herët ka pas me u bërë dy gropa septike, dhe nuk janë ndertu dy por vetëm një, dhe ajo ka qene e paraparë vetëm për një lagje por nuk ka kapacitet ajo gropë me u lidh gjithë ato lagje, dhe ne si fshat nuk jemi të pajtimit që fshati i Abrisë me u lidh me atë gropë septike sepse ajo gropë është në gjendje jo të mirë dhe po të lidhet edhe tjera lagje nuk është në rregull.

Idriz Hysenaj, Ne kemi shkuar sipas asaj se me i grumbulluar dy tri fshatra me një vend, shumica e rruarve të fshatra janë perfundu, kanë mbet vetëm lagje, dhe i kemi grumbullu ne tri fshatra për shkak të projekteve, qëllimi ka qene qe mos me humb mjete për projekte. Në jemi në synim qe t'i përfundojmë rrugët dhe kanalizimet dhe të vazhdojmë me projekte tjera.

Petrit Sinani, sa i përketë Draf Kornizës Buxhetore është mjaft e rëndësishme, është e rëndësishme edhe për qytetaret e komunës tonë, për arsye se me këtë dokument e kemi buxhetin për tri vitet e ardhshme. Të sektori i bujqësisë nuk kemi rritje, dhe buxheti i shëndetësisë është i pa mjaftueshëm në buxhetin që është paraparë dhe t'i dhajmë prioritet gjerave që kanë më shumë prioritet.

Fitore Morina, kanalizimi i ujërave të zeza nuk është në fshatin Korroticë e Naltë për vitin 2019-2020 dhe 2021 nuk është ne buxhet ndoshta është vetëm gabim.

Malsore Cakiqi, kërkoj që Tersteniku 1 dhe 2 të ndahen pasi që edhe në mënyrë administrative janë të ndara.

Kryesuesi-Labinot Halilaj, Hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës:

për votuan: 16

Kundër: 03

Abstenim: 06

Kryesuesi-Labinot Halilaj-hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës:
9.Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Drenasit për vitin 2017.

Sokol Bylykbashi, në këtë raport ka shumë shkelje si tek çështja 10-mangësi në planet për menaxhimin e kontratave, pastaj të çështja 9-mangësi në procesin e planifikimit dhe menaxhimit të projekteve, çështja 7-Ndarja e Tenderëve, këtu ka shumë shkelje dhe kërkoj t'i shikoni këto.

Kryetari i Komunës -z.Ramiz Lladroveci, këtu nuk ka shkelje, janë procedura që i kemi zhvilluar.

Kryesuesi-Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës:
10.Plotësim ndryshimin e rregullores nr.12-320-19338 të datës 07.04.2017, për kushtet, kriteret dhe procedurat e e ndarjes së subvencioneve.

Beqir Kiqina, unë kisha thënë me i propozu shumë pastaj me diskutu.

Petrit Gashi, ta caktojme një shumë dhe ta votojmë, unë propozoj 1 mij euro.

Shqipe Zogu, Neni 2 e specifikon 1500 euro si shumë maksimale, me pak është e lejuar ndërsa më shumë nuk është e lejuar, ky është një limit.

Burim Bujupi, është mirë për ta votuar këtë shumë maksimale

Kryesuesi-Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës:

për votuan: 21

kundër: 00

abstenim: 01

Kryesuesi-Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e 11 të rendit të ditës:

11.Propozim vendim për plotësimin dhe ndryshimin e ambullës për shpronësimin e pronës se paligjshme, të ndërtimit të Qendrës së Mjekësisë Familjare në Komoran ka qenë gabim teknik me qellim të ndërtimit të stadionit sintetik, ka sqaruar se është dashtë me qenë me qellim të ndërtimit të qendrës së mjekësisë familjare në Komoran.

Kryesuesi-Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës:

për votuan: 19

kundër: 00

abstenim: 02

Kryesuesi-Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e 12 të rendit të ditës:

12.Punsimet klienteliste në Komunen e Drenasit.

Florentina Elczi, një pyetje për Drejtorin e Arsimit mësueset e qendrës Dielli, 4 mësueset i keni larguar nga Drenasi i keni dërguar nëpër fshatra të larta pa ndonjë arsytim, pse ka ndodh kjo?

Kimete Bardhi, dua të ndërlihem të parafolësja varet nga kualifikimi, ata që kanë pas të përfunduar fakultetin privat, ligji iu lejon më të transfere në mungesë të kuadrit, e nëse ka pas të kualifikuar të shtetit kjo është e mundshme me ndodh.

Kryetari i Komunës-z.Ramiz Lladrovci, ligji ia ka lejuar punëtorëve të arsimit që kanë qenë proces arsimor me përfundim shkollimin, për rikualifikim dhe rritjen e kredisë, ato mësimdhënësë i kemi bërë transfero për shkak se 9 mësimdhënësë për 4 klasë kanë marrë paga koti. Për punësim duhet me pas shkollimin bazë dhe përvojën e punës.

Beqir Kiqina, kam një kërkesë nga Kryetari i Komunës, dhe nga Drejtoria për Rini Kultur dhe Sport, që me u merr ma shumë me klubet e sportit, dua ta theksoj klubin e shahut i cili është në nivel shumë të mirë që ka arrit suksese ku me janë adresua disa kërkesa nga ky klub ku vetëm për këtë vit janë ndare një shumë e pamjaftueshme, na e dimë që nuk munden më me ndryshu, por nga donatorët nëse vinë me ia nda për këtë sport, dhe të klubi i boksit janë ndare 150 mijë euro dhe janë shumë pak dhe nuk kanë kushte, as palestër dhe asgjë nuk iu ka ofrua deri me tash.

Kryetari i Komunës-z.Ramiz Lladrovci, Komuna ka aq mundësi dhe nuk ka mundësi më shumë.

Burim Bujupi, kam një kërkesë për fshatin Arllat për kanalizim dhe për zhavorr, ende nuk ka dal askush me shikua atë rrugë. Dhe e kam një propozim rreth shëndetësisë në Arllat janë 2 mjek dhe 3 teknik, nëse keni mundësi me bë një ndarje, dhe me i zgjat orarin e punës.

Kryetari i Komunës-z.Ramiz Lladrovci, Për kanalizim ne jemi të detyruar me i mirëmbajë kanalizimet e ujerave të zeza, ndërsa për në shëndetësi e kemi bërë orarin deri në ora 9 në Komoran dhe Drenas për shërbime të qytetareve dhe në Arllat do ta bëjmë një zgjidhje.

Sabrie Kukaj, pse ka stagnua ndërtimi i shtratit të lumit, deri ku kanë shkuar proceduar dhe a ka shpresa me fillu puna.

Drejtori për Urbanizëm, projekti është bërë, por sipas projektit duhet me i rrënuar katër shtëpi, kemi kërkuar me ndryshu projektin dhe mos me i rrënu shtëpitë, përveç një jemi të obliguar, punimet janë duke vazhduar, ndërsa për urë kemi vendos me ia ndrru vendin sepse aty nuk kemi hapësirë për ta zgjeruar më shumë.

Hamit Kastrati- Kërkojmë që Komuna të na mbështet për të ndërtuar një çerdhe në fshatin Nekovc . Në fshatin tonë janë vetëm dy institucione publike, shkolla dhe ambulanca, por kemi nevojë për ndërtimin e një çerdhe për fëmijët tanë e cila është shumë e nevojshme.


Petrit Gashi, kërkesë e cila ka ardh prej qytetarëve për rrugen “Rasim Kiqina” për vendosjen e disa pengesave në rrugë, për shkak të vozitjes së shpejt të veturave, një kërkesë tjetër për mbikalim në Llapushnik, dhe kërkoj për mbylljen një nje grope rrugën Llapushnik, Kishnarekë është një gropë e rrezikshme dhe kërkojmë ta mbylлим atë gropë.

Mbledhja përfundoi në ora 17:15

Procesmbajtësi:

Liridona Fejza-Ajazi

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës:


Labir Hot Halilaj